




Kompania Rajonale e Ujësjetësimit  
"Hidroregjioni Jugor" SH.A.  
"Vatrat Shqiptare", p.n. 20000 Prizren  
Tel/Fax; 029/ 244-150 029/ 244-107  
E-mail; sh.a-hidroregjionijugor-prizren@hotmail.com



Bordi i Drejtorëve i Kompanisë Rajonale të Ujësjetësimit "Hidroregjioni Jugor" Sh. A me seli në Prizren në përputhje me nenin 31 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087 për raportet vjetore dhe tremujore dhe nenin 18 Ligji Nr. 04/L-111 Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, në mbledhjen e mbajtur me datë 28.02.2023 mori këtë:

## VENDIM

### RAPORTIN VJETOR-2022

Bordi i Drejtorëve miratoi njëzëri raportin vjetor për vitin 2022 në mbledhjen e pesëmbëdhjetë (15) të mbajtur me datë 28.02.2023.

	Delegoi	Aprovoi
Emri Mbiemri	Kryeshefi Ekzekutiv Zenel Zenelaj	Kryesuesi i BtD Feim Fetoshi
Nënshkrimi		
Data	28.02.2023	28.02.2023



# RAPORT VJETOR



# 2022

KOMPAJNA PUBLIKE DIESSELLET  
 PËR SHPËRIMIN E UJËT SHKËMBORËVE  
 »HIDROREGJIONI JUGOR« SH.A.D.D.  
 Nr. 522  
 D. 28.02 2023  
 PRIZREN

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA /  
 REPUBLIC OF KOSOVO  
 QEVERIA • VLADA • GOVERNMENT  
 MINISTRIA E EKONOMISE  
 MINISTARSTVO EKONOMIJE  
 MINISTRY OF ECONOMY

Njësia Org. 01/3 Nr. Prof. 750  
 Org. Jedin. 01/3 Br. Prof. 750  
 Org. Unit 01/3 Prof. No. 750  
 Nr. i faqeve 1 Data: 03.03.23  
 Broj stranica 1 Date: 03.03.23  
 No. pages 1 Date: 03.03.23

PRISHTINE/A NO.1

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A  
 Rr. Wesley Clark p.n. Prizren 20000  
[www.hidroregjioni-jugor.com](http://www.hidroregjioni-jugor.com)  
[info@hidroregjioni-jugor.com](mailto:info@hidroregjioni-jugor.com)  
[konsumatori@hidroregjioni-jugor.com](mailto:konsumatori@hidroregjioni-jugor.com)

# 1.Përmbajtja

## Zonat e përgjegjësish së K.R.U. „HIDROREGJIONI JUGOR”

4

## 2. RAPORTI I KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE

6

2.1	Të dhënat kryesore gjatë vitit 2022	6
2.2	Te dhenat per drejtot jo- ekzekutiv	9
2.2.1	Emrat e drejtove te bordit te drejtove (Te përkohshëm)	9
2.2.2	Numri i takimeve te bordit te drejtove	9
2.2.3	Numri i takimeve te Komisionit te Auditimiti	10
2.2.4	Informacionet e tjera te bordit gjate vitit 2022	17
2.3	Informacionet lidhur me kapitalin dhe dividenden	21
2.4	Kredit e rendesishme te nenshkruara apo paguara gjate vitit	21

## 3 RAPORTI I ZYRTARIT KRYESOR EKZEKUTIV

22

3.1	Ngjarjet kryesore të vitit	22
3.1.1	<b>DEPARTAMENTI TEKNIK</b>	22
3.1.2	<b>Situata e furnizimit – NJ.P. - Janar –Dhjetor 2022</b>	22
3.1.3	Aktivitetet kryesore	23
3.1.4	Problemet e hasura gjatë kësaj periudhe	30
3.1.5	Masat e realizuara/ mos realizuara nga periudha paraprake	30
3.1.6	Masat e propozuara për periudhën në vazhdim	30
3.2	Pasqyrat e performancave operative nga Shërbimi Teknik	31
3.2.1	Prodhimi – Janar-Dhjetor 2021-2022	33
3.2.2	Prodhimi – Realicimi i caqeve -2022	33
<b>3.3</b>	<b>DEPARTAMENTI KOMERCIAL</b>	<b>34</b>
3.3.1	Aktivitetet kryesore- Janar –Dhjetor 2022	34
3.3.2	Raport I ankesave teknike dhe komerciale	34
3.3.3	Raporti ekipes se inspektimit dhe shkyqjes	35
3.3.4	Problemet e hasura gjatë kësaj periudhe	35
3.3.5	Masat e realizuara/ mos realizuara nga periudha paraprake	36
3.3.6	Masat e propozuara për periudhën në vazhdim	36

3.4	Performancat nga Shërbimi për Konsumatorë- Nr. I Faturave	37
3.4.1	Numri i Faturave- Janar-Dhjetor-2022	37
3.4.2	Numri i Faturave- 2021-2022	39
3.4.3	Numri i Faturave- Janar-Dhjetor-2022 (Caqet – PB-2022)	40
3.5	Performancat nga Shërbimi për Konsumatorë - Faturimi – m3	41
3.5.1	Faturimi – m3- Janar-Dhjetor-2022	41
3.5.2	Faturimi – m3- 2021-2022	43
3.5.3	Faturimi – m3- Janar-Dhjetor-2022 (Caqet – PB-2022)	43
3.6	Performancat nga Shërbimi për Konsumatorë- Faturimi – €	46
3.6.1	Faturimi €- Janar-Dhjetor-2022	46
3.6.2	Faturimi €- 2021-2022	46
3.6.3	Faturimi €- Janar-Dhjetor-2022 (Caqet – PB-2021)	48
3.7	Performancat nga Shërbimi për Konsumatorë - Arkëtimi – €	49
3.7.1	Arkëtimi €- Janar-Dhjetor-2022	49
3.7.2	Arkëtimi €- 2021-2022	51
3.7.3	Arkëtimi €- Janar-Dhjetor-2022 (Caqet – PB-2022)	51
3.7.4	Tarifat €- 2020-2023	53
3.7.5	Tarifat €- 2021-2022	53
<b>3.8</b>	<b>DEPARTAMENTI I FINANCAVE</b>	<b>54</b>
3.8.1	Aktivitetet kryesore - Janar –Dhjetor 2022	54
3.8.2	Problemet e hasura gjatë kësaj periudhe	55
3.8.3	Masat e realizuara/ mos realizuara nga periudha paraprake	55
3.8.4	Masat e propozuara për periudhën në vazhdim	55
3.9	Shpenzimet €	56
3.9.1	Shpenzimet € - Janar-Dhjetor 2022	56
3.9.2	Arsyeshmëria e Shpenzimeve € - 2022	58
3.9.3	Shpenzimet € - 2021-2022	60
3.9.4	Shpenzimet € - Janar-Dhjetor -2022 (Caqet- PB- 2022)	60
3.9.5	Shpenzimet € - 2022 - ITUN	61
3.9.6	Pagesat nga Përbaruesit privat - 2022	62

---


<b>4</b>	<b>Personeli</b>	<b>63</b>
4.1	Personeli – Janar-Dhjetor 2021-2022	63
4.2	Personeli – Janar-Dhjetor – 2022 (CAQET- PB-2022)	64
<b>5</b>	<b>TREGUESIT KRYESOR TË PERFORMANCAVE</b>	<b>64</b>
5.1	Performancat – Janar-Dhjetor - 2022	64
5.2	Performancat – Janar-Dhjetor – 2021-2022	66
5.3	Performancat – Janar-Dhjetor – 2022 ( Caqet – PB – 2022)	66
5.4	Performancat kryesore 2021-2022	67
5.5	Realizimi i Caqeve - 2022	68
5.6	Transaksionet kryesore - 2022	69
<b>6</b>	<b>DEPARTAMENTI ADMINISTRATIV</b>	<b>70</b>
6.1	Aktivitet kryesore	70
6.2	Raport i zyres ligjore	76
6.3	Lëndet që rrezikojne Kompaninë	78
6.4	Lëndet nga Përmbaruesi privat - 2022	79
<b>7</b>	<b>RAPORT I AUDITORIT</b>	<b>82</b>
<b>8</b>	<b>AKTIVITETET E ZYRËS SË PROKURIMIT</b>	<b>85</b>
<b>9</b>	<b>PASQYRAT FINANCIARE</b>	<b>94</b>
<b>10</b>	<b>PERSPEKTIVA PËR VITIN E ARDHSHËM</b>	<b>97</b>
<b>11</b>	<b>INVESTIMET KAPITALE</b>	<b>98</b>
<b>12</b>	<b>INVESTIMET E PLANIFIKUARA - 2023</b>	<b>102</b>
<b>13</b>	<b>DEPARTAMENTI - ITUN</b>	<b>103</b>
<b>14</b>	<b>ORGANOGRAMI</b>	<b>107</b>

---

# ZONAT E PËRGJEGJËSISË SË K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A

KRU" HIDROREGJIONI JUGOR" Sh.A Prizren

Mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit, viti 2022



LEGJENDA:	
05	Zona e shërbimit
05	Qytetet me ujë
75	Fshatrat me ujë që menaxhohen nga HRJ
118	Venbanimet pa shërbime të ujësjellësit

Punoi: Shërbimi TEKNIK

## 2. RAPORTI I KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE

### 2.1 Të dhënat kryesore gjatë vitit 2022

#### FURNIZIMI

Furnizimi i konsumatorëve me ujë të pijes brenda 24 orëve në ditë, për periudhën njëvjeçare Janar-Dhjetor të vitit 2022, në nivel regional duke përfshirë të gjitha njësitë punuese e operuese, ka qenë kryesisht i rregullt por i shoqëruar me ulje presioni në disa zona më problematike dhe aplikimin e reduktimeve parciale të furnizimit.

Në NJP – Prizren, gjatë tremujorit të parë Janar – Mars, reduktimet janë aplikuar në qytetin e Prizrenit në pjesën dërmuese të zonave të qytetit (zonat e qendrës së qytetit, zonat e lagjeve „Bajram Curri“, „Jeta e Re, pjesërisht „Arbana“, lagjeve Tusus dhe Dardania dhe lagjeve Bazhdarana, Janina dhe Petrova). Në njësitë tjera operuese, Suharekë, Malishevë dhe Dragash nuk janë shfaqur probleme të theksuara të furnizimit me ujë të pijes në pjesët urbane, me përjashtim të aplikimit të reduktimeve parciale të paplanifikuara në disa zona rurale në mungesë të energjisë apo prishjeve në rrjet.

Faktori kryesor që ka ndikuar drejtpërdrejtë në destabilizimin e furnizimit me ujë të pijes dhe ka vazhduar të ndikojë ishte zvogëlimi i kapaciteteve të burimeve ujore si rezultat i kushteve shumë të pavolitshme atmosferike për resurset ujore që kanë mbretëruar për këtë periudhë afërsisht deri në mesin e muajit Mars. Faktorët tjerë gjithashtu me ndikim serioz që kanë shoqëruar vështirësitë e furnizimit, uljen e presionit dhe aplikimin e reduktimeve janë keqpërdorimet enorme të ujit të pijes, defektet të shumta si pasojë e infrastrukturës parciale tejet të amortizuar dhe ndërprerjeve të shpeshta planifikuara dhe të paplanifikuara të energjisë elektrike nga KEDS.

Në muajt Janar-Dhjetor, bazuar në faktorët e sipërshtuar, përkundër vështirësive të sipër evidentuara, në përgjithësi kemi realizuar furnizimin kualitativ me objektiv konsistent në arritjen e standardeve aplikative të cilësisë 100% të ujit të pijes duke ndërmarrë në vazhdimësi aktivitetet e duhura në operim dhe mirëmbajtje për funksionim optimal të sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimit.

**UJI I PRODHUAR**

Për periudhën Janar-Dhjetor 2022, në nivel regjional, janë raportuar prodhim të ujit prej **16,850,892.00 m<sup>3</sup>**. Krahasuar me vitin 2021 kemi rënie të lehtë të prodhimit të ujit të pijes për **77,612.00 m<sup>3</sup>**.

**FATURIMI - m<sup>3</sup>**

Gjatë vitit 2022 në nivel regjional janë faturuar **7,804,162 m<sup>3</sup>** me një rritje të faturimit prej **+85,377 m<sup>3</sup> (+1.11%)** krahasuar me vitin 2021.

**FATURIMI - €**

Gjatë vitit 2022 në nivel regjional janë faturuar **5.302.953,73 €** me një rritje të faturimit prej **+108.570,03 € (+2.09%)** krahasuar me vitin 2021.

**ARKËTIMI - €**

Gjatë vitit 2022 në nivel regjional janë arkëtuar **5.181.571,95 €** me një rritje të arkëtimit prej **+33.041,58 € (+0.64%)** krahasuar me vitin 2021.

**UJI I PAFATURUAR**

UPF, në aspektin teknik dhe komercial, vazhdon të mbetet një ndër sfidat kryesore të kompanisë. Mbështetur në angazhimin e të gjitha shërbimeve dhe në përkrahjen e donatorëve dhe institucioneve vendore kemi planifikuar dhe ndërmarrë aktivitete investive në vazhdimësi për përmirësimin dhe përmbushjen e konditave teknike dhe parakushteve tjera të domosdoshme me prioritet në zvogelimin e humbjeve të ujit.

Departamenti Teknik me të gjithë sektorët e tij ka bërë dhe vazhdon me përpjekje të pandërprera për të evidentuar dhe dixhitalizuar infrastrukturën ekzistuese, mbarëvajtjen e realizimit të projekteve investive në harmoni me mundësitë buxhetore dhe sanimin në kohë optimale dhe efikase të prishjeve, rrjedhjeve të pakontrolluara, keqpërdorimeve dhe dëmtimeve tjera të mundshme në rrjet. Investimet kapitale me mjete vetanake dhe me përkrahjen e komunave, konform PB 2022 dhe projeksioneve të ARRU-së, kanë arritur përqindjen e admirueshme (sipas draft raporteve të përmbledhura - mbi 100 %) që pritet të ketë impakt dhe ndikim domethënës në UPF sikurse dhe në rritjen e efikasitetit të shërbimeve të operimit e mirëmbajtjes dhe shërbimeve tjera..

Raportet tregojnë që UPF në nivel regjional për vitin 2022 është **53.69 %**, me një rënie prej **0.72 %** krahasuar me vitin 2021.

#### **SHPENZIMET - €**

Gjatë vitit 2022 në nivel regjional shpenzimet kanë arritur në **4.128.566,28 €** me një rritje të shpenzimeve prej **+182.933,06 € (+4.64%)** krahasuar me vitin 2021.

#### **MBULIMI OPERATIV**

Gjatë vitit 2022 në nivel regjional Kompania ka arritur të ketë mbulim operativ prej 1.26 apo **+1.053.005,67 €** mbi shpenzimet operative.

## 2.2 TË DHËNAT PËR DREJTOR – JO- EKZEKUTIV

### 2.2.1 Emrat e drejtorëve të bordit të drjetorëve

1. *Feim Fetoshi* - *Keyesues i Bordit*
2. *Mirlinda Morina* - *Anëtare e Bordit ( Kryesuese e KA)*
3. *Hysni Çanta* - *Anëtar i Bordit*
4. *Biljal Karadolami* - *Anëtar i Bordit*
5. *Naim Kukaj* - *Anëtar i Bordit*
6. *Arben Hajrizi* - *Anëtar i Bordit*

### 2.2.2 Numri i takimeve të Bordit të Drejtoreve gjatë vitit 2022

MBLEDHJET E BORDIT TË PERKOHSHEM TË DREJTORËVE  
K.R.U.„HIDROREGJIONI JUGOR” SH. A- PRIZREN

(të Emëruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me vendimin Nr.31/39 të datës 13.10.2021-13.04.2022)

NR.	DATA	VENDI	VËREJTJE
1	06.01.2022	Prizren	Testi me shkrim për KE
2	21.02.2022	Prizren	Intervista për KE
3	31.01.2022	Prizren	
4	28.02.2022	Prizren	
5	31.03.2022	Prizren	

**MBLEDHJET E BORDIT TË DREJTORËVE K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A-PRIZREN**

(të Emëruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me vendimin Nr. 04/92 të datës 10.08.2022)

NR.	DATA	VENDI	VËREJTJE
1	25.08.2022	Prizren	
2	30.08.2022	Prizren	
3	16.09.2022	Prizren	
4	27.09.2022	Prizren	
5	17.10.2022	Prizren	
6	28.10.2022	Prizren	
7	14.11.2022	Prizren-MPVA	
8	30.11.2022	Prizren	
9	16.12.2022	Prizren	
10	22.12.2022	Prizren	
11	30.12.2022	Prizren	

**MBLEDHJET E KOMISIONIT TË AUDITIMIT  
K.R.U. „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A- PRIZREN**

(të Emëruar nga Ministria e Ekonomisë me vendimin Nr.1908 të datës 15.08.2022)

NR.	DATA	VENDI	VËREJTJE
1	29.08.2022	Prizren	
2	23.09.2022	Prizren	
3	25.10.2022	Prizren	
4	24.11.2022	Prizren	
5	27.12.2022	Prizren	

**Informacione për Bordin e drejtoreve gjatë vitit 2022**

Raporti vjetor i Bordit të Drejtoreve në KRU "Hidroregjioni Jugor" SHA në Prizren, në formë përmbledhëse përfshin aktivitetet kryesore të Bordit të Përkohshëm Drejtorëve të realizuara gjatë muajve janar-mars 2022.

Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve gjatë muajve janar-mars 2022 ka mbajtur tri (3) takime të rregullta mujore si dhe takimet për intervistën e përzgjedhjes së Kryeshefit Ekzekutiv. Sipas procesverbaleve takimet e Bordit janë mbajtur me këto data: 06.01.2022, 21.01.2022, 31.01.2022, 28.02.2022, 31.03.2022.

Tani KUR Hidroregjioni Jugor SH.A Prizren është duke u udhëhequr nga Bordi i Drejtorëve i emëruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me Vendim Nr. 04/92 të datës 10.08.2022.

Bordi i drejtorëve është i përbërë nga 6 drejtorë në përbërje prej: Feim Fetoshi - Kryesues, Hysni Çanta - anëtar, Mirlinda Morina - anëtare, Naim Kukaj - anëtar, Arben Hajrizi - anëtar dhe Biljal Karadolami – anëtar.

Gjatë vitit 2022 nga të dy Bordet e Drejtorëve janë mbajtur 16 takime të rregullta.

Në këto takime Bordi i Drejtorëve përveç diskutimeve të frytshme po ashtu ka marr veprimet si vijon:

- Aprovimi i Plan Biznesit për vitin 2023-2025,
- Aprovimi i Raportit të Kompanisë për TM4-2021,
- Aprovimi i Raportit vjetor Operativ dhe Financiar për vitin 2021.
- Aprovimi i Raportit të Kompanisë për TM2-2022,
- Aprovimi i Raportit të Kompanisë për TM3-2022,
- Është mbajtur Mbledhja e Përgjithshme Vjetore me Aksionarin në K.R.U.”Hidroregjioni Jugor” Sh. A Prizren (për vitin 2021).
- Aprovimi i Pasqyrave Financiare të Audituar nga Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2021 .
- Mbështetur në Ligjin Nr. 03/L-087, “Mbi Ndërmarrjet Publike”, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe Ligjin Nr. 05/L-009 si dhe bazuar në Ligjin Nr. 06/L-016, “Për Shoqëritë Tregtare” neni 197 i këtij Ligji është aprovuar nga Bordi Ndryshim Statuti i Kompanisë Rajonale të Ujësjiellit “Hidroregjioni Jugor “SH.A, në Prizren, Nr. 01-04/01, datë 19.05.2020.
- Aprovimi i Raportit vjetor për vitin 2021 ne MPVA.
- Aprovimi i Raportëve të Zyrarëve të auditimit të brendshëm.
- Aprovimi i raportit mbi Hulumtimin e Kënaqshmërisë së Konsumatorëve për periudhën janar-dhjetor 2021 në zonën e shërbimit të cilën e mbulon KRU “Hidroregjioni Jugor” Sh.A Prizren.
- **Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve në takimin e mbajtur me 06.01.2022** është kryer intervista me shkrim me kandidatet e përzgjedhur nga Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve për pozitën e punës Kryeshef Ekzekutiv në KRU”Hidroregjioni Jugor”Sh. A ne Prizren.
- **Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve në takimin e mbajtur me datë 21.01.2022** është kryer intervista me gojë me kandidatet e përzgjedhur nga Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve për pozitën e punës Kryeshef Ekzekutiv në KRU”Hidroregjioni Jugor”Sh. A ne Prizren. Pas kalimi të afatit të ankesës Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve i Kompanisë Rajonale të Ujësjiellit “Hidroregjioni Jugor” Sh. A me seli në Prizren, duke u bazuar në nenin 21 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087, Ligjin për Shoqëritë Tregtare Nr. 06/L-016, Statutit të Kompanisë , me datë 26.01.2022 mori VENDIM mbi zgjedhjen e Kryeshefit Ekzekutiv në KRU”Hidroregjioni Jugor”Sh. A,Prizren

- **Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve në takimin e mbajtur me datë 31.01.2022**, pas diskutimit lidhur me tërheqjen e njëanshme nga kontrata e operatorit që furnizon me klor-gaz, Bordi sugjeroi KE që të takohen me Ministren e Ekonomisë ashtu si është planifikuar nga Kryeshefat Ekzekutiv të gjitha KRU-të dhe ta diskutoni sepse problemi qenka i përbashkët për krejt KRU-të.
  - Në këtë takim Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve për takimin e radhës kërkoj nga Menaxheri i projektit të ITUN dhe Zyrtari Kryesor Financiar raport të detajuar lidhur me rrjedhën e pagesave në projektin e ITUN si dhe një analizë të kontratës së projektit të ITUN.
  - Bordi e përkrahu planifikimin e mundësive për shtim të kapaciteteve të ujit në Prizren, duke apeluar që të punohet me projekte konkrete në këtë drejtim .
  - Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve në K.R.U" Hidroregjioni Jugor" Sh. A, në Prizren, në përputhje me nenin 31(31.2) të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087 për raportet tremujore dhe nenin 18 Ligji Nr. 04/L-111 Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve i **njësori miratoi Raportin Operativ dhe Financiar për TM-4 / 2021 të KRU" Hidroregjioni Jugor" Sh.A .**
  - Bordi i Përkohshëm Drejtoreve i K.R.U" Hidroregjioni Jugor" Sh. A, në Prizren bazuar në kompetencat komform nenit 7, paragrafi 2 i Statutit të K.R.U" Hidroregjioni Jugor" Sh. A, si dhe kërkesat që dalin nga Neni 34.3 i Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike, pas shqyrtimit të bërë **njësori miratoi "Rregulloren për rregullimin e procedurave të konkursit në KRU" Hidroregjioni Jugor" Sh. A, dhe Rregulloren për menaxhimin e kërkesave dhe dokumentacionit financiar nga Logjistika.**
- **Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve në takimin e mbajtur me datë 28.02.2022**, në përputhje me nenin 31 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087 për raportet vjetore dhe tremujore si dhe nenin 18 Ligji Nr. 04/L-111 Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, pas shqyrtimit të bërë **miratoi Raportin vjetor Operativ dhe Financiar për vitin 2021.**
  - Në këtë takim Bordi i Përkohshëm Drejtorëve njësori vendosi që ti vazhdohet kontrata e punës Zyrtarit Kryesor Financiar dhe të Thesarit edhe për një vit përkatësisht deri në pensionim të tij.
- **Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve në takimin e datës 31.03.2022**, në përbërje të plotë, në përputhje me nenin 29 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087 për Raportet mbi Përbushjen e Nevojave të Klientëve dhe nenin 16 Ligji Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe nenit 7 të Ligjit Nr. 05/L-009 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111, njësori miratuan raportin mbi Hulumtimin e Kënaqshmërisë së Konsumatorëve për periudhën janar-dhjetor 2021 në zonën e shërbimit të cilën e mbulon KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh. A Prizren.
  - Në këtë takim Bordi i Përkohshëm i Drejtoreve bazuar në Vendimin e KNMU të datës 16.02.2022 rekomanduan Kryeshefin Ekzekutiv dhe Menaxhmentin e Kompanisë të rishikojnë Strukturën organizative, Rregulloren për Organizimin e brendshëm dhe

sistematizimin e vendeve te punës si dhe koeficientet e pagave për të gjitha pozitat e stafit te Kompanisë, brenda afatit te paraparë në këtë Vendim.

- Me pastaj Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve bëri vlerësimin e kryerjes së detyrave të punës për Zyrtarët e Lartë të Kompanisë për vitin 2021: për Kryeshefin Ekzekutiv, Zyrtarin Kryesor Financiar, Sekretaren e Kompanisë dhe Auditorin e Brendshëm të Kompanisë. Me vlerësimin e performancës së përgjithshme të kryerjes së detyrave të punës për Zyrtarët e Lartë të Kompanisë u pajtuan të gjithë anëtarët prezent të Bordit të Përkohshëm të Drejtorëve të KRU "Hidroregjioni Jugor"sh. A, Prizren dhe Zyrtarët e Kompanisë
- **Bordi i Drejtorëve në takimin informues të mbajtur me 25.08.2022** 2021 është bërë prezantimi i anëtareve të Bordit dhe njoftimi i tyre me Kryeshefin Ekzekutiv dhe Menaxhmentin e Lartë në KRU "Hidroregjioni Jugor"Sh.A., Prizren. Nga Kryeshefi Ekzekutiv në këtë takim u paraqit raport njoftues për Bordin e Drejtorëve që përfshinte zonën menaxhuese, realizimi i caqeve të planifikuara në PB, investimet, rreziqet e kompanisë dhe performancën operative dhe financiare të Kompanisë.
- Bazuar në Ligjin për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087 përkatësisht nenin 35.3, nga të gjithë drejtorët e Bordit u nënshkrua Zotimi mbi respektimin e Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative.
- **Bordi i Drejtorëve në takimin e datës 30.08.2022** kërkoj nga Zyrtari kryesor financiar dhe Menaxheri i departamentit me konsumator për të gjeturën e ZKA-së te "llogaritë e arkëtueshme" që për çështjet për të cilat mendojnë se nuk mund të realizohen brenda këtij viti, të i japin Bordit (brenda një muaji) propozim me analizë konkrete se çfarë duhet verpruar që të eliminohet kjo e gjetur në të ardhmen.  
(Të informohet Bordi me dokumente, duke pasqyruar gjendjen e llogarive te arkëtueshme te detajuar, në mënyrë që të kemi politiken e qartë si me vepruar me tutje).
- Në këtë takim Bordi i Drejtorëve pas shqyrtimit të raportit të auditimit te Zyrës Kombëtare të Auditimit për pasqyrat financiare vjetore te Kompanisë dhe Planit të Veprimit për adresimin e gjetjeve dhe rekomandimeve për auditimin e vitit 2021, **miratoi njëzëri Pasqyrat Financiare të Audituar nga Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2021.**
- Në këtë takim Bordi kërkoj nga zyra ligjore sqarim lidhur me lëndët gjyqësore që rrezikojnë kompaninë, arësyet se si kanë ndodhur, si dhe për shkelje të procedurave që eventualisht kanë ndodhur në Kompani.
- Në këtë takim, Bordi kërkoj raport për faturimin e ujit në objektet apo asetet e kompanisë për secilën njësi punuese për tri vitet e fundit.
- Në këtë takim Bordi i Drejtorëve në KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh. A, në Prizren, në përputhje me nenin 31(31.2) të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087 për raportet tremujore dhe nenin 18 Ligji Nr. 04/L-111 Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, **miratoi njëzëri Raportin Operativ dhe Financiar për TM-2 / 2022 të KRU " Hidroregjioni Jugor" Sh.A .**

- **Bordi i Drejtorëve në takimin e dates 16.09.2022** , mbështetur në Ligjin Nr. 03/L-087, “Mbi Ndërmarrjet Publike”, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe Ligjin Nr. 05/L-009 si dhe bazuar në Ligjin Nr. 06/L -016, “Për Shoqëritë Tregtare” neni 197 i këtij Ligji, Bordi i Drejtorëve i KRU “Hidroregjioni Jugor” Sh. A, njëzëri miratoi Vendim që të Ndryshohet Statuti i Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit “Hidroregjioni Jugor “ SH .A, në Prizren, Nr. 01-04/01, datë 19.05.2020.

Ky ndryshim bëhet në pajtim me Nenin 197, paragrafi 1, të Ligji Nr. 16/L-016 për Shoqëritë Tregtare. Ndryshimet në Statut janë: emrat e Bordit të Drejtorëve te neni 14 i Statutit;

  - Në këtë takim Bordi kërkoj që përmes Sekretares së Kompanisë të kërkohet takim në mes të dy Bordeve (Bordit të KRU "Gjakova" dhe Bordit të KRU "Hidroregjioni Jugor"). Qëllimi i takimit me Bordin e KRU "Gjakova" është të diskutojmë çështjet me interes të përbashkët të Ndërmarrjeve ndër të tjera edhe çështjen e objektit respektivisht edhe Marrëveshjen mbi qiranë e objektit në Ortakoll - Prizren.
  - Në këtë takim, pas shqyrtimit dhe diskutimit nga të pranishmit Bordi i drejtorëve aprovoi njëzëri për **Zëvendës Kryesues të Bordit z. Hysni Çanta**, i cili do të drejtojë takimet e Bordit të drejtorëve kur Kryesuesi i Bordit nuk është prezent në takim të Bordit.
  - Në këtë takim Bordi kërkoj nga Kompania që para se të shpallet tenderi për Auditor të jashtëm për vitin 2022 të dërgohet paraprakisht në Komision të Auditimit për ndonjë sugjerim apo plotësim.
  
- **Bordi i Drejtorëve në takimin e datës 27.09.2022** , angazhon Sekretaren e Kompanisë që në emër të Bordit t’i drejtohet duke kërkuar interpretim profesional në NJPMNP dhe në Agjencinë Kundër Korrupsion, lidhur me dy rastet e rekrutimit të punonjësve në Kompani që dyshohet së janë konflikt interesi duke kërkuar interpretim ligjor dhe mendim profesional!

Raste, kanë të bëjnë me dy procese të rekrutimit të punëtorëve, ku pavarësisht procedurave të zhvilluara nga komisionet selektuese, bazuar në emrat e punonjësve të përzgjedhur, vërehet se janë familjarë të afërt, kanë pasur, apo edhe kanë në njëfarë forme raporte me KRU “Hidroregjioni Jugor”sh.a. Për këto dy konkurse (Porto-arkë dhe punëtor në bazhdarim) Bordi kërkoj auditim specifik nga Auditori i Brendshëm lidhur me shkeljet procedurale. Po ashtu për këto dy konkurse kërkohet vlerësim apo mendim - interpretim profesional nga zyra ligjore.

  - Në këtë takim Bordi konstatoi - Shumica e anëtarëve të Bordit (5 anëtar Bordi), vlerësuan se nga veprimet apo mos veprimet e Kryeshefit me këto dy konkurse (ku është punësuar ish Kryesuesja e Bordit te Përkohshëm dhe bashkëshorti i anëtares së Bordit aktual), është dëmtuar imazhi i kompanisë.
  - Në këtë takim sugjerim i Bordit ishte që nga Kompania të punohet në drejtim që konsumatorët të njoftohen me mesazh në telefon paraprakisht për ndërprerje të furnizimit me ujë.
  - Në këtë takim Bordi kërkoj raport: Raport nga Kryeshefi Ekzekutiv lidhur me shkeljet e deklaruara në Bord për ish Kryeshefin Ekzekutiv të kompanisë. Raport nga Auditori i Brendshëm lidhur me borxhin e Kek-ut dhe mos respektimin e kontratës për falje të

borxhit. Raport nga Zyrtarit Kryesor Financiar raport lidhur me ndëshkimet e kompanisë pas kontrollës së ATK-së.

- Në këtë takim Bordi i drejtoresve, mbështetur në pozicionin e pagave të Plan - biznesit për vitin 2022 dhe bazuar në Kërkesë - Propozimin e Zyrtarit Kryesor Financiar dhe të Thesarit të KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh A si dhe pas aprovimit Kërkesë - Propozimit nga Komisioni i Auditimit, Nga Bordi i Drejtoresve aprovohet njëzëri rritja shujtës ditore për ditë pune nga 2.50 euro bruto në 4 € euro bruto për të gjithë të punësuarit në KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh A.
- **Bordi i Drejtoresve në takimin e datës 17.10.2022**, vendosi që te investimet kapitale të planifikuara me mjete vetanake të shtohet arsyeshmeria e tyre bazuar në kërkesat e ARRU-së si dhe të rishikohet masat konkrete nga secili shërbim i kompanisë.
- Në këtë takim Bordi kërkoj që për takimin e Nëntorit, Menaxheri teknik të përgatisë raport mbi gjendjen e çdo pike të prodhimit të ujit, për ujëmatës të prodhimit dhe atyre zonal. Raporti të përfshijë burimin ku mungon ujëmatësi, ku matët me ujëmatës dhe ku matet vetëm me pompa. Ndërsa nga Menaxheri rajonal me konsumator u kërkua të përgatitet tabelë që përfshin adresën e objektit të kompanisë që harxhohet uji me numër të ujëmatësit.
- **Bordi i Drejtoresve në takimin e datës 28.10.2022**, lidhur me investimet ne Mamushë Bordi kërkoj swot analizë se çka është investuar deri me tani dhe çka parashihet të investohet në të ardhmen sepse nuk është e çartë çështja e furnizimit me ujë të Mamushës.
- Bordi i Drejtoresve i Kompanisë Rajonale të Ujësjetës "Hidroregjioni Jugor" Sh. A me seli në Prizren, në përputhje me nenin 30 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087 për Plan-Biznes si dhe në përputhje me nenin 17 të Ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike për Plan-Biznes, **njëzëri miratoi Plan Biznesin e KRU " Hidroregjioni Jugor" Sh. A, për vitin 2023-2025.**
- Nga Bordi i drejtoresve mbeti që Struktura Organizative e Kompanisë që është pjese përbërëse e Plan Biznesit 2023-2024, të rishikohet gjatë implementimit te Vendimit Nr. KNMU/V/02/2022 datës 16.02.2022, të nxjerr nga Kryeministri i Republikës së Kosovës njëkohësisht edhe Kryesues i Këshillit Ndërmnistror për Ujëra.
- **Bordi i Drejtoresve në takimin e datës 30.11.2022**, u kërkua nga Kryeshefi Ekzekutiv të angazhoi inxhinierët e Kompanisë që deri ne mbledhjen tjetër te dhjetorit të japin analizë duke shqyrtuar kostot e dy alternativave si opsione që kanë propozuar në ARRU për furnizim me ujë të Mamushës (analiza të përfshij koston financiare dhe analizën e pasjes së ujit te mjaftueshëm).
- Në këtë takim Bordi kërkoj planin në të cilën përshkruhet sa mostra të analizave te ujit duhet të bëhen brenda muajit sipas standardeve të mostrimit.
- Ne këtë takim Bordi i Drejtoresve në K.R.U "Hidroregjioni Jugor" Sh. A, në Prizren, në përputhje me nenin 31(31.2) të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087 për raportet tremujore dhe nenin 18 Ligji Nr. 04/L-111 Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, **njëzëri miratoi Raportin Operativ dhe Financiar për TM-3/2022 të KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh.A .**

- Në këtë takim Bordi e mirëpriti zotimin e Kryeshefit dhe të Menaxherit teknik që deri në fund të këtij viti të gjitha burimet e ujit do të jenë më ujëmatës dhe nga janari uji i prodhuar do të matet me ujëmatësja e që raporti i janarit të vjen në Bord real ashtu si do të duhej të jetë.
- Në këtë takim Bordi i analizoj lëndët që janë aktualisht në Gjykatë dhe rrezikojnë Kompaninë, duke sugjeruar Ekzekutivit të bashkëpunojë më shumë me stafin që të jenë të kujdesshëm në mënyrë që aspak apo sa më pakë të krijohen shkelje gjatë ekzekutimit të punëve, dhe të jenë më të sjellshëm gjatë komunikimit me palë. Për paraqitjen e kontesteteve eventuale të bëjë përpjekje që të kryhen me marrëveshje pa shkuar lënda në Gjykatë dhe për çështjet të cilat shkojnë apo janë në Gjykatë të bëjë më të mirën të mundshme që Kompania të mbrohet me së miri.
- Në këtë takim Bordi i Drejtorëve njëzëri miratoi shpërblimin për të gjithë të punësuarit e Kompanisë Rajonale të Ujësjetës "Hidroregjioni Jugor" Sh. A me nga 100€ euro bruto, për shkak të inflacionit në vend si dhe me rastin e festës së vitit e Ri 2023.
- **Bordi i Drejtorëve në takimin e datës 16.12.2022,** Bordi shqyrtoi propozimin e komisionit për Shqyrtimin e organogramit dhe sistematizimit të vendeve të punës të paraqitur Bordit për miratim dhe pasi pa se në disa pika nuk pajtohet me atë propozim vendosi që vet Bordi të merret me trajtimin dhe analizimin e kësaj çështje dhe të bëjë ndryshime aty ku e konsideron të arsyeshme dhe të nevojshme, natyrisht gjithnjë duke pasur në asistencë Kryeshefin (si pjesë e Bordit) dhe anëtarët e komisionit.
- **Bordi i Drejtorëve në takimin e datës 22.12.2022,** Konform me funksionet dhe kompetencat që parashihen Nenit 21 Ligjit për Ndërmarrje Publike Nr. 03/L-087, Ligji Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporatave, Bordi i Drejtorëve i KRU "Hidroregjioni Jugor"SHA,Prizren, në mbledhjen e mbajtur më 22.12.2022 **Aprovoi njëzëri të përgatitet Konkursi për pozitën e punës së Zyrtarit Kryesor Financiar dhe të Thesarit ne KRU"Hydroregjioni Jugor"Sh. A Prizren,** si dhe Konkursi të shpallet sipas kriterëve të miratuara nga Bordi i drejtorëve në këtë takim. Konkursi të shpallet në shtypin ditor duke u bazuar në Ligjin për Ndërmarrjet Publike, Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporatave për Ndërmarrjet Publike dhe Statut të Kompanisë.
- Në këtë takim Bordi paraqiti shqetësim për çështjen e pezullimit të licencës së shërbimit të Kompanisë për zonën shërbimit në Komunën e Mamushë. Bordi kërkon që për këtë çështje të adresohet përgjegjësia pse ka ndodhur një gjë e tillë. Nga Kryeshefi Ekzekutiv u kërkua që për mbledhjen tjetër të përgatitë raport për Bordin lidhur me çështjen e Mamushës me sqarime se pse ka ardhur deri te ky pezullim dhe të adresohet përgjegjësia! Bordi njëzëri kërkoj nga Auditori i Brendshëm që menjëherë të filloj auditim të përgjithshëm me procedura të jashtëzakonshme për çështjen e Mamushës.
- Në këtë takim Bordi shqyrtoi, analizoi dhe trajtoi çështje të organogramit dhe sistematizimit të vendeve të punës, dhe vazhdoi punën atë ku ka mbetur nga mbledhja e

kaluar! Në fund u vendos që në mbledhjen e ardhshme të vazhdohet me shqyrtim dhe trajtim aty ku mbeti në këtë mbledhje!

- **Bordi i Drejtorëve në takimin e datës 30.12.2022,**
- Bordi shqyrtoi, analizoi dhe trajtoi qështje të organogramit dhe sistematizimit të vendeve të punës, dhe vazhdoi punën atë ku ka mbetur nga mbledhja e kaluar! Në fund u vendos që me trajtimin e kësaj teme të merret edhe në fillim të vitit 2023, duke u takuar si bord sa më shpesh që të jetë e mundur me qëllimin që në fund të miratohet një vendim sa më i përshtatshëm, efektiv dhe gjithëpërfshirës i cili do të ndikoj direkt në të mirë gjithë punëtorëve, menaxhmentit dhe të KRU “Hidroregjioni Jugor” sh.a. në përgjithësi.
- Në këtë takim u trajtua raporti i Kryeshefit për rastin e pezullimit të licencës për Mamushë dhe pas shqyrtimit të raportit, nga Bordi i drejtorëve u shqiptua vërejtje për Kryeshefin Ekzekutiv për shkak të përgjegjësisë që ka për pezullimin e licencës së Mamushës për mosadresim të përgjegjësisë, si dhe pasi i njëjti nuk po e merr përgjegjësinë për këtë pezullim përkundër faktit se i njëjti në 3 vitet e fundit ka qenë në krye të kompanisë (2 vite si UD - Kryeshef dhe 1 vit si Kryeshef me mandat të rregullt).
- **Bordi i Drejtorëve në takimin e MPVA me datë 14.11.2022,** në Mbledhjen Përgjithshme Vjetore me Aksionarin miratoi njëzëri Pasqyrat Financiare të Audituar nga Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2021, u miratua njëzëri Raporti vjetor për vitin 2021, si dhe njëzëri u miratua Performanca e Menaxhmentit të Kompanisë për vitin 2021.

#### 2.2.4 Aktivitetet tjera të Bordit të Drejtorëve gjatë vitit 2022

- Bordi i Drejtorëve prej emërimit me date 10.08.2022 ishte në kontakt të vazhdueshëm me Menaxhmentin e Kompanisë.
- Në vazhdimësi ka kërkuar dhe është njoftuar, në kontakt direkt por edhe në formë të shkruar, për gjendjen dhe zhvillimet në kompani.
- Është mbikëqyrë menaxhimi kompanisë dhe janë dhënë këshillat e nevojshme për Kryeshefin Ekzekutiv.
- Në takimet e rregullta janë mbikëqyrë të gjitha ecuritë e biznesit, mbarëvajtja e tyre sipas vendimeve të Bordit si dhe aspekti ligjorë i vendimeve të Menaxhmentit të kompanisë. Lidhur me këtë Bordi i Drejtorëve është i informuar për të gjitha vendimet dhe zhvillimet e rëndësishme.

- Është bërë shqyrtimi dhe aprovimi i raporteve tremujore për vitin 2022 (duke u bazuar në raportet mujore); dhe në kornizën ligjore të Ligjit për NP.
- Janë dorëzuar në NJPMNP të aprovuara raportet si në vijim: Raporte tremujore për aksionarin (ME); ( raporti TM2, TM3, raporti vjetor për 2022, Raporti i auditimit nga ZKA për vitin 2021) dhe raporte mujore për ARRU-në.

Bordi i Drejtorëve falënderon Kryeshefin Ekzekutiv, stafin menaxhues të Kompanisë dhe gjithë punëtorët për angazhimin e tyre në rritjen e performancave të kompanisë dhe në përmirësimin e shërbimeve ndaj konsumatorëve. Bordi shprehë një mirënjohje të veçantë për të gjithë donatorët KFW, ME dhe Komunitat e zonës së shërbimit për bashkëpunim dhe mbështetje në realizimin e shumë projekteve për në interes të Kompanisë.

Bordi kërkon nga Kryeshefi Ekzekutiv një angazhim më të madh në vitin 2023, dhe pret përbushje në plotëni të Planit të Biznesit, avancime në rritjen e shërbimeve për konsumator, furnizim më të rregullt me ujë, zgjerim të zonave të shërbimit, zvogëlimin e humbjeve dhe rritjen e performancave në të gjitha nivelet tjera!

### **Raport vjetor i punës së Komisionit të Auditimit për vitin 2022.**

Raporti vjetor i Komisionit të Auditimit të KRU "Hidroregjioni Jugor" SHA në Prizren, në formë përmbledhëse përfshin aktivitetet kryesore të Komisionit të Auditimit të realizuara gjatë vitit 2022.

Bazuar në procesverbalet zyrtare të mbajtura, gjatë këtij viti, janë mbajtur 5 takime të Komisionit të Auditimit. Poashtu, shumë çështje janë shqyrtuar drejtpërdrejtë në takimet e rregullta të Bordit të Drejtorëve.

Takimi i parë i Komisionit të Auditimit është mbajtur me datë 29.08.2022, me përbërje të plotë të 3 anëtarëve, Mirlinda Morina - Kryesuese e Komisionit të Auditimit, Naim Kukaj - anëtarë i K.A dhe Arben Hajrizi – anëtar i K.A.

Konkluzionet, vendimet dhe rekomandimet e dhëna të Komisionit të auditimit, kanë qenë:

- Komisioni i Auditimit për takimin e radhës kërkoj nga shërbimi me konsumator raport për llogaritë e arkëtueshme të ndarë për institucione, biznese dhe amvisëri, për tri vitet e fundit.
- Me propozim të Kryesueses së Komisionit, Komisioni i Auditimit kërkoj nga Zyrtari Kryesor Financiar që plani i veprimit për raport të ZKA të jetë me i detajuar duke cekur zyrtarin përgjegjës si dhe të përfshihet sa nga te gjeturat e raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit sa janë realizuar dhe sa janë në proces të implementimit.
- Plani i plotësuar sipas kërkesës së Komisionit të dërgohet sot gjatë ditës në mënyrë që të diskutohet nesër në takim të Bordit të Drejtorëve.

- Komisioni i Auditimit kërkoj që për takimin e Bordit të drejtorëve të përgatitet lista e investimeve kapitale sa janë realizuar dhe sa janë në procedurë të realizimit për këtë vit. Lista investimeve e kërkuar të dërgohet gjatë ditës anëtarëve të Bordit.
- Komisioni i Auditimit pas shqyrtimit të raportit të performancës për TM2-2022 aprovoi të njëjtin me plotësim të përfshirjes në raport edhe listën e investimeve të kompanisë.

Takimi i dytë i Komisionit të Auditimit është mbajtur me datë 23.09.2022, me përbërje të plotë të 3 anëtarëve të K.A.

Konkluzionet, vendimet dhe rekomandimet e dhëna të Komisionit të auditimit, kanë qenë:

- Kryesuesja e Komisionit të Auditimit kërkoj për takim të Bordit, që shërbimi me konsumator të paraqesë në analitik listën e borxheve të bizneseve dhe institucione duke përfshirë edhe emrat e bizneseve dhe institucionit përkatës.
- Po ashtu për takim të Bordit, Anëtari i Komisionit, z.Hajrizi kërkoj listën e pagesës së ujit nga punëtorët e kompanisë.
- Komisioni i Auditimit kërkoj nga Auditori i Brendshëm auditim lidhur me faturimin apo mos faturimin e qendrës tregtare “Galeria” dhe “Abi Çarshia”, sipas procedurave ligjore dhe rregullave të ARRU-së. Raporti të përgatitet për takimin e radhës së Komisionit të Auditimit.
- Komisioni i Auditimit kërkoj raportin nga Auditori i Brendshëm sqarim detaj sa janë ndjekur procedurat për largimin e punëtorëve nga puna dhe a janë zbatuar të gjitha procedurat ligjore sipas ligjit në fuqi.
- Komisioni i Auditimit pasi shqyrtoj propozimin e Zyrtarit Kryesor Financiar për rritje të vlerës së shujtës ditore të punëtorëve të HRJ rekomandon Bordin për aprovim të këtij propozimi, pasi që janë dhënë arsyeshmëritë financiare të detajuara.
- Kryesuesja e Komisionit të Auditimit kërkoj që me 30.09.2022 t'ju dërgohet Draft Plan Biznesi tek Bordi i Drejtorëve.

Takimi i tretë i Komisionit të Auditimit është mbajtur me datë 25.10.2022, me përbërje të plotë të 3 anëtarëve.

Në këtë takim, janë diskutuar dhe shqyrtuar disa tema, me ç'rast edhe janë marrë vendime, të paraqitura si në vijim:

Konkluzionet, vendimet dhe rekomandimet e dhëna të Komisionit të auditimit, kanë qenë:

- Komisioni i Auditimit kërkoj nga shërbimi i financave dhe shërbimi me konsumator listën e konsumatorëve të kompanisë që janë raste sociale.

- Komisioni Auditimit shqyrtoj raportin e TM3-2022, duke e deleguar në Bord për shqyrtim dhe aprovim.
  - Komisioni diskutoj edhe mundësinë e punësimit së një lektori në kompani, që do të lekturonte të gjitha dokumentet zyrtare të kompanisë, dhe se kjo çështje mbeti te diskutohet ne takim të Bordit.
  - Komisioni i Auditimit kërkoj nga departamenti teknik raport përmbledhës lidhur me strategjinë e marrjes së graveve për projektet kapitale të vitit 2023 të cilët kanë objektiv vlerën prej 36 milion euro.
  - Komisioni kërkoj elaborat me arsyeshmëri lidhur me investimet e bëra në Mamushë duke përfshirë edhe investimet e planifikuara për vitin 2023 për Mamushë.
  - Komisioni i Auditimit për takimin e Bordit, rekomandoi që në plan biznes të përfshihet edhe struktura organizative me pozitat aktuale në Kompani. Bordi të vendos se me cilën skemë organizative të miratohet Plan biznesi.
  - Komisioni i Auditimit falënderoj Auditorin e Brendshëm për raportin e paraqitur lidhur me caqet e planifikuara dhe të realizuara nga Plan Biznesi i kompanisë për gjashtë mujorin e parë 2022, duke krahasuar me parametrat e Biznes Planit Rregullativ të dhënë gjatë aplikimit tarifor në ARRU dhe Caqet vjetore të përcaktuara nga KNMU.
- Komisioni i Auditimit kërkoj që raporti i njëjtë i Auditorit të Brendshëm të prezantohet ne takim të Bordit te Drejtorëve.

Takimi i katërt i Komisionit të Auditimit është mbajtur me datë 24.11.2022, me përbërje të plotë të 3 anëtarëve të Komisionit.

Konkluzionet, vendimet dhe rekomandimet e dhëna të Komisionit të auditimit, kanë qenë:

- Në mungesë të Zyrtarit për raportim Komisioni i Auditimit vendosi që raporti i performances se Kompanisë për tetor/2022, të shqyrtohet në takim te Bordit të Drejtorëve të datës 30.11.2022.
- K.A, pas sqarimeve të Drejtorit Teknik lidhur me çështjen e Mamushës, Komisioni i Auditimit kërkoj që raporti për ARRU të dërgohet me kohë duke respektuar afatin e dhënë në paralajmërim e ARRU-së për Mamushën.
- Pas shqyrtimit dhe diskutimit detal të Skemës organizative, nga Komisioni i Auditimit mbeti që për takim të Bordit të prezantohen krahasimet dhe arsyeshmeria e kërkuar nga Kryesuesja e Komisionit të Auditimit për pozitat e larta që janë shtuar në organogramin aktual për dallim nga varianti 3 i KNU .
- Komisioni kërkoj për takim të Bordit të shtypen nga një kopje e modelit të koeficientëve që është propozuar nga komisioni i kompanisë.

Takimi i pestë i Komisionit të Auditimit është mbajtur me datë 27.12.2022, me përbërje të plotë të 3 anëtarëve të Komisionit.

Në këtë takim, janë diskutuar dhe shqyrtuar disa tema, me ç'rast edhe janë marrë vendime, të paraqitura si në vijim:

Konkluzionet, vendimet dhe rekomandimet e dhëna të Komisionit të auditimit, kanë qenë:

- Komisioni i Auditimit aprovoi planin vjetor të punës së Auditorit të Brendshëm për vitin 2023.
- Komisioni i Auditimit, gjithashti aprovoi Planin Strategjik të punës së Auditorit të Brendshëm, për periudhën 2023-2025, me plotësim ndryshimet e kërkuara gjatë shqyrtimit nga KA.

### **2.3 Informacionet lidhur me kapitalin dhe dividenden**

Nuk ka pasë pagesa në emër të dividendes

### **2.4 Kredit e rëndësishme të nënshkuara apo paguara gjatë vitit 2022**

Pagesa e kredisë per vitin 2022 në shumë prej 3.997.00 €

Pagesa e kredisë ka përfunduar në muajin Shtator 2022.

### 3. RAPORTI I ZYRTARIT KRYESOR EKZEKUTIV

#### 3.1 NGJARJET KRYESORE TË VITIT

##### 3.1.1 RAPORT NGA DEPARTAMENTI TEKNIK

##### 3.1.2 SITUATA E FURNIZIMIT – JANAR – DHJETOR 2022

Furnizimi i konsumatorëve me ujë të pijes brenda 24 orëve në ditë, për periudhën njëvjeçare Janar-Dhjetor të vitit 2022, në nivel regional duke përfshirë të gjitha njësitë punuese e operuese, ka qenë kryesisht i rregullt por i shoqëruar me ulje presioni në disa zona më problematike dhe aplikimin e reduktimeve parciale të furnizimit.

Në NJP – Prizren, gjatë tremujorit të parë Janar – Mars, reduktimet janë aplikuar në qytetin e Prizrenit në pjesën dërmuese të zonave të qytetit (zonat e qendrës së qytetit, zonat e lagjeve „Bajram Curri“, „Jeta e Re, pjesërisht „Arbana“, lagjeve Tusus dhe Dardania dhe lagjeve Bazhdarana, Janina dhe Petrova). Në njësitë tjera operuese, Suharekë, Malishevë dhe Dragash nuk janë shfaqur probleme të theksuara të furnizimit me ujë të pijes në pjesët urbane, me përjashtim të aplikimit të reduktimeve parciale të paplanifikuara në disa zona rurale në mungesë të energjisë apo prishjeve në rrjet.

Faktori kryesor që ka ndikuar drejtpërdrejtë në destabilizimin e furnizimit me ujë të pijes dhe ka vazhduar të ndikojë ishte zvogëlimi i kapaciteteve të burimeve ujore si rezultat i kushteve shumë të pavolitshme atmosferike për resurset ujore që kanë mbretëruar për këtë periudhë afërsisht deri në mesin e muajit Mars. Faktorët tjerë gjithashtu me ndikim serioz që kanë shoqëruar vështirësitë e furnizimit, uljen e presionit dhe aplikimin e reduktimeve janë keqpërdorimet enorme të ujit të pijes, defektet të shumta si pasojë e infrastrukturës parciale tejet të amortizuara dhe ndërprerjeve të shpeshta planifikuara dhe të paplanifikuara të energjisë elektrike nga KEDS.

Në muajt Janar-Dhjetor, bazuar në faktorët e sipërsëhënuar, përkundër vështirësive të sipër evidentuara, në përgjithësi kemi realizuar furnizimin kualitativ me objektiv konsistent në arritjen e standardeve aplikative të cilësisë 100% të ujit të pijes duke ndërmarrë në vazhdimësi aktivitetet e duhura në operim dhe mirëmbajtje për funksionim optimal të sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimit.

### 3.1.3 AKTIVITETET KRYESORE JANAR-DHJETOR 2022

- Angazhimet dhe menaxhimet e përditshme te punëve komfor detyrimeve dhe përgjegjësi të vendit të punës dhe jashtë tyre për operimin dhe funksionimin optimal të Departamentit Teknik në veçanti dhe Kompanisë në përgjithësi.
- Takimet e rregullta ditore, javore dhe periodike të menaxhmentit, me bashkëpunëtorët, me udhëheqësit e njësive punuese, shërbimet operative dhe shërbimet tjera të Kompanisë.
- Takimet me institucionet komunale, qeveritare, institucione financiare donatore, me konsumatorë, me palë, etj.
- Takimet me ARRU, KNMU, Institutin Metrologjik, me sektorët Ministror të ujit dhe energjisë dhe Institucionet e agjensionet e ndërlidhura drejtpërdrejte apo indirekt me monitorimin e Kompanisë dhe të tjera të ngjashme në funksion të përgjegjësi dhe përmbushjes së detyrimeve karshi standardeve operuese aplikative.
- Raportet e rregullta për menaxhmet, KE, BD, ARRU dhe Institucionet tjera monitoruese dhe ndërvepruese me Kompaninë.
- Përgjigjet dhe shkëmbimet e shkresave përmes komunikimeve elektronike e fizike dhe pjesëmarrja në takimet e aranzhuara përmes platformës dixhitale – ZOOM.
- Aplikimi dhe procedimi i kërkesave, ankesave dhe shkresave zyrtare që lëshon DT - Përgjigjeve në kërkesa, Dhënia e kushteve teknike, Lejeve, Vendimeve dhe Pëlqimeve komfor Rregulloreve të zbatueshme të Kompanisë.
- Harmonizimi i projekteve investive dhe dokumentacioneve përkatëse teknike me të gjitha Institucionet financiare komunale, vendore e tjera, përpilimi dhe finalizimi i projekt propozimeve te përgatitura nga DT.
- Ofrimin e shënimeve të kërkuara për auditorët e Zyrës Kombëtare të Auditimit;
- Deklarimet ligjore ndaj ATK-së, për Tatimet në burim, të ardhura personale, tatimin e vlerës së shtuar, deklarimet e TM-së për korporatat e mëdha, si dhe deklarimet e pasqyrave financiare;
- Përgatitja e raporteve mujore financiare, si inkasimin, të hyrat dhe ato të shpenzimeve, gjithashtu edhe raportet tremujore për ARRU, ASK, Ministrinë
- Kontrollimi dhe barazimi i të pagueshmeve dhe atyre të arkëtueshmeve,
- Hapja dhe përgatitja e pagave për muajtë përkatës, kontrollim, barazim dhe verifikim të regjistrit të të punsuarve;
- Raportet ditore nga shërbimi i arkës, gjendjen e arkës në lidhje me inkasimet ditore, ato të amëvisisë, bizneseve, gjendjen e llogarive bankare, kontimin e tyre, barazimet etj;
- Kontrollimi dhe nënshkrimi i kërkesave për blerje, si dhe aprovimi i tyre për blerje;
- Kontrollimi dhe pranimi i faturave për blerjet si dhe regjistrimi i tyre në kontabilitet, pas kontrollimeve;
- Pagesa e furnitorëve, pas kontrollimit të blerjeve; barazimi i të pagueshmeve;
- Plotesimin e librave të blerjes dhe shitjes sipas ligjeve dhe formës standarte të kërkuar nga ATK, për muajtë përkatës, mujor e tremujor;
- Raportimet tremujore ndaj Agjensisë së Statistikave të Kosovës;
- Përgatitja e shënimeve të nevojshme për përpilimin e Plan Biznesit për vitin 2023-2025
- Përgatitja e shënimeve për Rregullimin dhe Risistematizimin e vendeve të punës sipas Vendimit të Qeverisë së Kosovës dhe udhëzuesit të Këshillit Ndërmnistror të NMPNP, në bashkëpunim me të gjitha Departamentet e Kompanisë dhe të njejtat i janë dorëzuar Bordit të Drejtorëve për Miratim.

### 3.8.2 PROBLEMET E HASURA GJATË KËSAJ PERIUDHE

Duke e pare gjendjen financiare ne KRU Hidroregjioni Jugor Sh.A. Prizren, Kompania gjendet para tri problemeve të mëdha, respektivisht rreziqeve relativisht te mëdha:

- 1- **Vendimi i Gjykatës Themelore mbi borgjin e Kompanisë ndaj KEK** , për të cilin borgj ne kemi arrit marrëveshje me KEK-un për përmbushjen e obligimit për 12 vite . Obligimi vjetorë është 120,768.00 euro
- 2- **Pamundësia e inkasimit të llogarive të arkëtueshme** të vjetërsuara , ekziston rreziku i parashkrimit te borgjit . Duke u bazuar ne raportin financiar, kompania jonë ka kërkesa për llogari të arkëtueshme ne shumë prej **12,238,984.00** euro  
Këto llogari të arkëtueshme , ekziston rreziku që shuma dërmuese të jenë borgje të këqija pasi që shuma prej 7,086,649.09 janë borgje të provizionuara .
- 3- **Detyrimet kontigjente -kërkesat e punëtorëve ndaj kompanisë** që kanë vendim gjykate shuma 94,000.00 euro. Ekzistojnë edhe detyrime tjera kontigjente por që ende nuk kanë epilogë gjykate.

### 3.8.3 MASAT E REALIZUARA / MOS REALIZUARA NGA PERIUDHA PARAPRAKE

- Kompania ka arrit të që gjatë këtij tremujorë shi të përmbush obligimin ndaj ATK-së
  - Hapat e ndërmarra: Kompania ka arrit marrëveshje për programimin e borxhit me KEK-un ,dhe atë që borxhi të paguhet për 144 këste mujore .Shuma e këstit është **10,064.00 euro**. Ne deri tani kemi arritur të përmbushim me sukses këtë marrëveshje .

### 3.8.4 MASAT E PROPOZUARA PËR PERIUDHËN NË VAZHDIM

- Të bëhen përpjekje të vazhdueshme që të kërkohet ndihmë edhe nga ana e Qeveris së Kosovës përkatësisht MZE. për ndihmë financiare ne mënyrë që te përballohen këto probleme.
- Te bëhen përpjekje për inkasimin e llogarive të arkëtueshme para se ato të mundë të parashkruhen.

## 3.9 SHPENZIMET - €


3.9.1 SHPENZIMET - JANAR-DHJETOR -2022  
K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A - PRIZREN

Tabela Nr.29

2022														
No.	Të dhënat	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NENTOR	DHJETOR	JANAR-DHJETOR 2022
1	Total Shpenzimet Operative	314,785	324,327	338,415	321,185	326,678	335,330	347,726	336,431	354,434	351,661	349,459	428,130	4,128,566.28
2	Pagat	197,107	199,961	198,513	196,721	200,434	199,531	216,456	198,075	209,143	209,488	214,007	247,449	2,486,884.79
3	Rryma elektrike	85,300	79,033	83,386	80,771	76,850	72,563	76,599	74,346	74,107	77,208	78,258	76,272	934,692.08
4	Shpen. e derivateve	9,282	9,362	11,964	9,783	8,911	9,809	10,346	13,635	11,871	13,128	12,227	14,965	135,282.39
5	Mirem. dhe riparimet	10,020	11,497	13,988	12,670	6,742	14,833	7,705	12,327	16,753	18,531	18,491	24,299	167,858.18
6	Mirem. e automjeteve	2,613	2,602	4,817	3,257	3,347	4,897	1,786	6,622	5,812	4,833	2,336	18,994	61,916.88
7	Shpen.e taksave	9,730	9,322	7,965	6,159	8,081	5,373	10,409	6,763	12,414	5,782	5,662	8,735	96,396.26
8	Kemikaliet	536	440	294	-	5,816	2,810	4,973	6,934	963	7,597	-	5,540	35,902.61
9	Shpenzimet e tjera	198	12,112	17,487	11,824	16,498	25,515	19,451	17,729	23,372	15,093	18,478	31,876	209,633.09
2	Ndryshimi	(113,346)	9,542	14,088	(17,230)	5,494	8,651	12,396	(11,295)	18,003	(2,773)	(2,202)	78,672	-
3	Ndryshimi ne %	-36.0%	3.0%	4.3%	-5.1%	1.7%	2.6%	3.7%	-3.2%	5.4%	-0.8%	-0.6%	22.5%	(0)

Tabela Nr.30

2022														
No.	Të dhënat	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NENTOR	DHJETOR	JANAR-DHJETOR 2022
	Total Shpenzimet Operative	314,785	324,327	338,415	321,185	326,678	335,330	347,726	336,431	354,434	351,661	349,459	428,130	4,128,566.28



### 3.9.2 ARSYESHMËRIA E SHPENZIMEVE

Shpenzimet operative të ndërmarrjes për vitin 2022, në krahasim me shpenzimet e vitit 2021, janë më të larta, por performanca ka qenë më e mirë, në krahasim me vitin e kaluar;

- Më poshtë do t'i cekim disa nga pozicionet, të cilat kanë lëvizur më së shumti dhe arsytet e rritjes apo rënies së tyre;
- Nëse fillojmë nga pozicioni i shpenzimeve të pagave, në këtë pozicion, kemi rritje të shpenzimeve, pasi që në shtator të vitit 2022, me vendim të bordit, kemi rritje të shujtës nga 50 euro sa ka qenë, në 88 euro për muaj ose 4 euro për ditë pune;
- Rritje kemi edhe te pozicioni i energjisë elektrike në krahasim me vitin e kaluar, pasi që në vitin 2022 edhe faturimi ka qenë më i lartë dhe kjo është një nga faktorët edhe në rritje të shpenzimeve të energjisë elektrike;
- Edhe te pozicioni i derivateve kemi rritje të shpenzimeve, për shkak se në vitin 2022 çmimet e derivateve ka qenë më të larta dhe kjo është aryeja kryesor, poashtu ka pasur edhe aktivitete të ndërmarrjes në rritje të përmirsimit të shërbimit ndaj konsumatorëve;
- Ndërsa te pozicioni i mirëmbajtjes dhe riparimeve, dhe mirëmbajtjen e pompave, kemi nënje të të shpenzimeve, sidomos në njësinë e Prizrenit dhe Malidhevës, pasi që ka qenë nevoja më e vogël për intervenime në rrjet;
- Rënie të lehtë kemi pasur edhe te pozicioni i mirëmbajtjes së automjeteve; aryeja është se, s'kemi pasur intervenime të mëdha në automjete, përveç atyre të rregullta për mirëmbajtje;
- Edhe te shpenzimet e taksave kemi rënie, në krahasim me vitin e kaluar, pasi që shpenzimet për taksat e përmbaruesit kanë qenë më të ulta në këtë vit në krahasim me vitin e kaluar, ndërsa shpenzimet e anëtarësisë në SHUKOS edhe ato të ARRU-së mbetën të njëjta;
- Ndërsa rritje kemi në kategorinë e shpenzimeve të kemikaleve, pasi që edhe tek kjo kategori kemi rritje të çmimeve kemikaleve, pra në fillim të vitit 2022 është shkëputur kontrata e mëparshme nga mospërballimi i cmimeve. Ndërsa në kontratat aktive veç kemi rritje të cmimeve të tyre;
- Shpenzimet tjera, ku përfshihen shpenzimet e administratës, shpenzimet e telefonisë, shpenzimet e udhëtimeve zyrtare, shpenzimet tjera të ndyshme etj, kemi një rënie të këtyre shpenzimeve, pasi që në vitin e kaluar kemi pasur interes dhe ndëshkime nga ATK dhe kjo ka ndikuar direkt në rritje të shpenzimeve të kësaj kategorie;
- Pra si përfundim, shpenzimet për këtë vit, kanë qenë më të larta në krahasim me vitin 2021, për arsyet e cekura me lartë, pra për gjithë arsytet e cekura më lartë. Vlenë të theksohet se në totalin e shpenzimeve vjetore operative, nuk janë të përfshira edhe disa shpenzime si, shpenzimet e amortizimit si dhe shpenzimet e provizionimeve të arkëtueshmeve.

Shpenzimet Operative dhe Financiare krahasuar me Plan Biznesin për vitin 2022

Janë më të ulta për **10.67%** si rrjedhojë me sa vijon :

- Pozicioni I pagave është për **5.56%** më I ulët pasi që ne nuk kemi bërë rritje të pagave të parapara me Plan Biznes.
- Pozicioni i shpenzimeve të rrymes elektrike është për **10.6%** më I ulët në krahasim me P.Biznesin si rezultat :

1. Zvogelimi i resurseve ujore gjate periudhes Janar - Mars 2022 perkatesisht pushimi i punes se disa elektropompave ne mungese uji.
2. Eficienca e gjeneruar nga instalimi i stabilimenteve eficiente ne st. e pompimit - Sozi Nashec dhe ne stacione tjera me te vogla.
3. Rritja e perkujdesit te mirembajtjes dhe monitorimit te funksionimit efikas dhe eficient te stacioneve pompuese dhe stabilimenteve elektroenergjetike.

- Pozicioni I Shpenzimeve të derivative kemi rritje prej **52.48%** në krahasim me P.Biznesin si rrjedhojë e ngritjes relativisht të lartë të qmimeve të energjis elektrike.
- Pozicioni I shpenzimeve të mirëmbajtjes dhe riparimeve janë më të ulta për **49%** ,pasiqë intervenimet në rrjetë kanë qenë më të vogla sidomos në ITUN pasi që stabilimentet janë të reja si dhe një pjesë të shpenzimeve të konsiderueshme janë paguar nga vet operatori ekonomik AKUALI(Punëkryesi)

Pozicioni I shpenzimeve tjera është më I ulët pasi që disa obligime (ndëshkimet) ndaj ATK janë falur .

### 3.9.3 SHPENZIMET - 2021-2022

#### K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A – PRIZREN

Tabela Nr.31

SHPENZIMET - €					
No.	Të dhënat	JAN-DHJET - 2021	JAN-DHJET - 2022	DALLIMI	%
1	Total Shpenzimet Operative	<b>3,943,386.26</b>	<b>4,128,566.28</b>	<b>185,180.02</b>	<b>4.70%</b>
2	Pagat	2,372,430.43	2,486,884.79	114,454.36	4.82%
3	Rryma elektrike	870,081.43	934,692.08	64,610.65	7.43%
4	Shpen. e derivateve	88,868.60	135,282.39	46,413.79	52.23%
5	Mirem. dhe riparimet	159,651.75	167,858.18	8,206.43	5.14%
6	Mirem. e automjeteve	73,141.98	61,916.88	-11,225.10	-15.35%
7	Shpen.e taksave	90,457.95	96,396.26	5,938.31	6.56%
8	Kemikaliet	16,586.00	35,902.61	19,316.61	116.46%
9	Shpenzimet e tjera	272,168.12	209,633.09	-62,535.03	-22.98%

### 3.9.4 SHPENZIMET - 2022 (CAQET-PB-2022)

#### K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A - PRIZREN

Tabela Nr.32

SHPENZIMET - €					
No.	Të dhënat	JAN-DHJET 2022	JAN-DHJET - 2022 (PB)	DALLIMI	%
1	Total Shpenzimet Operative	<b>4,128,566.28</b>	<b>4,621,804.30</b>	<b>(493,238.02)</b>	<b>-10.7%</b>
2	Pagat	2,486,884.79	2,633,389.77	(146,504.98)	-5.6%
3	Rryma elektrike	934,692.08	1,045,470.95	(110,778.87)	-10.6%
4	Shpen. e derivateve	135,282.39	88,722.80	46,559.59	52.5%
5	Mirem. dhe riparimet	167,858.18	329,158.31	(161,300.13)	-49.0%
6	Mirem. e automjeteve	61,916.88	75,657.68	(13,740.80)	-18.2%
7	Shpen.e taksave	96,396.26	99,346.12	(2,949.86)	-3.0%
8	Kemikaliet	35,902.61	37,288.32	(1,385.71)	-3.7%
9	Shpenzimet e tjera	209,633.09	312,770.35	(103,137.26)	-33.0%

## 3.9.5 SHPENZIMET - € - ITUN

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A - PRIZREN  
JANAR-DHJETOR – 2022 – CAQET – 2022


Tabela Nr.33

SHPENZIMET - €					
No.	Të dhënat	JAN-DHJET - 2022	JAN-DHJET - 2022 (PB)	DALLIMI	%
1	Total Shpenzimet Operative	185,365.21	570,047.00	(384,681.79)	-67.5%
2	Pagat	124,940.50	181,345.00	(56,404.50)	-31.1%
3	Rryma elektrike	42,727.62	121,161.00	(78,433.38)	-64.7%
4	Shpen. e derivateve	10,837.81	1,000.00	9,837.81	983.8%
5	Mirem. dhe riparimet	1,410.57	170,595.00	(169,184.43)	-99.2%
6	Mirem. e automjeteve	981.16	2,000.00	(1,018.84)	-50.9%
7	Shpen.e taksave	-	-	-	#DIV/0!
8	Kemikaliet	-	18,231.00	(18,231.00)	-100.0%
9	Shpenzimet e tjera	4,467.55	75,715.00	(71,247.45)	-94.1%

**3.9.6 TË HYRAT NGA MBARUESIT PRIVAT  
JANAR – DHJETOR 2022  
KRU „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A**

Tabela Nr.34

	<i>Numri i pag.</i>	<i>Prizren</i>	<i>Dragash</i>	<i>Suharekë</i>	<i>Malishevë</i>	<i>Gjithsej</i>
<b>2022</b>		€	€	€	€	€
<b>Janar</b>	177	9,585.88	70.00	1,393.47	712.46	11,761.81
<b>Shkurt</b>	185	17,411.61	917.44	1,083.54	446.90	19,859.49
<b>Mars</b>	199	14,135.58	326.02	1,467.02	1,231.22	17,159.84
<b>Prill</b>	196	19,830.53	241.50	892.66	810.76	21,775.45
<b>Maj</b>	190	12,378.24	113.62	1,051.70	2,500.28	16,043.84
<b>Qershor</b>	190	10,774.17	176.56	595.00	785.32	12,331.05
<b>Korrik</b>	188	11,144.75	65.00	1,147.57	776.58	13,133.90
<b>Gusht</b>	186	16,470.13	20.00	85.00	1,889.58	18,464.71
<b>Shtator</b>	171	11,378.79	565.93	758.75	208.04	12,911.51
<b>Tetor</b>	211	12,283.36	886.54	320.00	313.83	13,803.73
<b>Nëntor</b>	214	11,549.36	52.00	522.74	332.55	12,456.65
<b>Dhjetor</b>	204	10,773.08	202.00	306.78	296.08	11,577.94
<b>TOTAL</b>		<b>157,715.48</b>	<b>3,636.61</b>	<b>9,624.23</b>	<b>10,303.60</b>	<b>181,279.92</b>



#### 4. PERSONELI

##### 4.1 PERSONELI - JANAR - DHJETOR 2021-2022

Tabela Nr.35

Nr.	VITI	2021	2022
	<b>N.PUNESE</b>		
1	<b>PRIZREN</b>	244	240
2	<b>SUHAREKË</b>	36	35
3	<b>DRAGASH</b>	16	16
4	<b>MALISHEVË</b>	36	35
5	<b>HIDROREGJIONI</b>	332	326
6	<b>NDRYSHIMI</b>		-6
7	<b>NDRSHI. - %</b>		-1.8%

##### 4.2 PERSONELI

JANAR-DHJETOR – 2021 (CAQET- PB-2021)

KRU „HIDROREGJIONI JUGOR " SH.A – PRIZREN

Tabela Nr.36

Nr.	VITI	PB-2022	2022
	<b>N.PUNESE</b>		
1	<b>PRIZREN</b>	264	240
2	<b>SUHAREKË</b>	39	35
3	<b>DRAGASH</b>	18	16
4	<b>MALISHEVË</b>	41	35
5	<b>HIDROREGJIONI</b>	362	326
6	<b>NDRYSHIMI</b>		-36
7	<b>NDRSHI. - %</b>		-9.9%

## 5. TREGUESIT KRYESOR TË PERFORMANCËS


### 5.1 JANAR-DHJETOR - 2022

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR“

SH.A - PRIZREN

Tabela Nr.37

Treguesit e Performancës	[Njesia]	2022												
		JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NENTOR	DHJETOR	JANAR-DHJETOR 2022
Uje i faturuar-si perqindje	%	46.1%	46.0%	45.6%	46.1%	46.2%	46.4%	46.5%	46.6%	46.6%	46.4%	46.5%	46.50	46.3%
Uje i pafaturuar-si perqindje	%	53.9%	54.0%	54.4%	53.9%	53.8%	53.6%	53.5%	53.4%	53.4%	53.6%	53.5%	53.50	53.7%
Norma e arketimit - e pergjithshme	%	99.81	87.84	107.79	86.81	92.79	81.39	90.12	116.04	92.53	101.85	103.54	112.19	97.72
Norma e arketimit - Amviserite	%	93.28	90.24	106.11	85.02	84.04	80.43	84.67	118.05	88.75	103.90	96.46	112.88	95.29
Norma e arketimit - Komerical-Industrial	%	177.30	102.00	88.40	103.74	109.83	81.83	108.36	93.32	92.65	90.68	124.46	99.78	105.14
Norma e arketimit - Institucional	%	3.31	48.61	164.46	76.55	155.06	89.93	110.91	141.70	137.67	103.20	125.72	125.82	107.41
Norma e Mbulimit operativ	numer	1.25	1.07	1.20	1.18	1.28	1.12	1.29	1.88	1.29	1.26	1.22	1.06	1.26
Staf per 1000 konsumatore	numer	6.04	5.96	5.87	5.93	5.86	5.81	5.77	5.77	5.79	5.80	5.77	5.64	5.84



## 5.2 TREGUESIT KRYESOR TË PERFORMANCËS K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A - PRIZREN

### JANAR-DHJETOR - 2021 - 2022

Tabela Nr.38

Treguesit e Performancës		JAN-DHJET -2021	JAN-DHJET -2022	DALLIMI
Uje i faturuar-si perqindje	%	45.60%	46.3%	0.7
Uje i pafaturuar-si perqindje	%	54.40%	53.7%	0.7
Norma e arketimit - e pergjithshme	%	99.92	97.72	-2.2
Norma e arketimit - Amviserite	%	99.83	95.29	-4.5
Norma e arketimit -Komerical-Industrial	%	96.18	105.14	9.0
Norma e arketimit -Institucional	%	108.24	107.41	-0.8
Norma e Mbulimit operativ	numer	1.30	1.26	-0.04
Staf per 1000 konsumatore	numer	6.10	5.84	-0.26

## 5.3 TREGUESIT KRYESOR TË PERFORMANCËS JANAR-DHJETOR - 2021 (CAQET-PB-2021)

Tabela Nr.39

Treguesit e Performancës		JAN-DHJET -2022	JAN-DHJET -2022 (PB)	DALLIMI
Uje i faturuar-si perqindje	%	46.3%	48.05%	-1.75%
Uje i pafaturuar-si perqindje	%	53.7%	51.95%	1.75%
Norma e arketimit - e pergjithshme	%	97.72	<b>92.82</b>	<b>4.90</b>
Norma e arketimit - Amviserite	%	95.29	<b>91.40</b>	<b>3.89</b>
Norma e arketimit -Komerical-Industrial	%	105.14	<b>97.27</b>	<b>7.87</b>
Norma e arketimit -Institucional	%	107.41	<b>98.00</b>	<b>9.41</b>
Norma e Mbulimit operativ	numer	1.26	1.18	0.08
Staf per 1000 konsumatore	numer	5.84	<b>6.91</b>	<b>-1.07</b>

**1.4 RAPORT I PERFORMANCËS OPERATIVE DHE  
FINANCIARE  
2021-2022**

Tabela Nr.40

MUAJI	2021	2022	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
<i>Prodhimi m3</i>	16,928,504	16,850,892	(77,612)	(0.46)
<i>Faturimi m3</i>	7,718,785	7,804,162	85,377	1.11
<i>Faturimi nga uji €</i>	5,067,105.65 €	5,231,120.09 €	164,014.44 €	3.24
<i>Faturimi- te tjera €</i>	127,278.14 €	71,833.73 €	- 55,444.41 €	(43.56)
<b><i>Faturimi Total €</i></b>	<b>5,194,383.79 €</b>	<b>5,302,953.82 €</b>	<b>108,570.03 €</b>	<b>2.09</b>
<i>Inkasimi nga uji €</i>	5,063,189.32 €	5,111,620.87 €	48,431.55 €	0.96
<i>Inkasimi - te tjera €</i>	85,341.05 €	69,951.08 €	- 15,389.97 €	(18.03)
<b><i>Inkasimi Total €</i></b>	<b>5,148,530.37 €</b>	<b>5,181,571.95 €</b>	<b>33,041.58 €</b>	<b>0.64</b>
<i>Nr. i Konsumatorëve</i>	54,104	56,525	2,421	4.47
<i>% e inkasimit</i>	99.92	97.72	(2.2)	(2.21)
<b><i>Shpenzimet</i></b>	<b>3,945,633.22 €</b>	<b>4,128,566.28 €</b>	<b>182,933.06 €</b>	<b>4.64</b>
<i>Pagat</i>	2,313,502.71 €	2,486,884.79 €	<b>173,382.08 €</b>	<b>7.49</b>
<i>Rryma elektrike</i>	900,722.51 €	934,692.08 €	<b>33,969.57 €</b>	<b>3.77</b>
<i>Shpe. e derivateveve</i>	97,289.88 €	135,282.39 €	<b>37,992.51 €</b>	<b>39.05</b>
<i>Miremb. Dhe riparimet</i>	164,272.20 €	167,858.18 €	<b>3,585.98 €</b>	<b>2.18</b>
<i>Miremb, e automjeteve</i>	71,545.73 €	61,916.88 €	- <b>9,628.85 €</b>	<b>(13.46)</b>
<i>Shpen. E taksave</i>	100,059.44 €	96,396.26 €	- <b>3,663.18 €</b>	<b>(3.66)</b>
<i>Kemikalet</i>	17,158.04 €	35,902.61 €	<b>18,744.57 €</b>	<b>109.25</b>
<i>Shpenzimet tjera</i>	281,082.71 €	209,633.09 €	- <b>71,449.62 €</b>	<b>(25.42)</b>
<i>Uji I pafaturuar në m3</i>	9,209,719	9,046,730	(162,989)	(1.77)
<i>Uji I pafaturuar ne %</i>	54.40	53.69	(0.7)	
<i>Mbulimi operativ</i>	1.30	1.26	(0.05)	
	1,202,897.15 €	1,053,005.67 €	(149,891.48)	

## 5.5 RAPORT I PERFORMANCËS OPERATIVE DHE FINANCIARE REALIZIMI I CAQEVE- PB-2022

Tabela Nr.41

MUAJI	2022- PB	2022	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
<i>Prodhimi m3</i>	18,174,509	16,850,892	(1,323,617)	-7.28%
<i>Faturimi m3</i>	8,733,532	7,804,162	(929,370)	-10.64%
<i>Faturimi nga uji €</i>	5,837,885.03 €	5,231,120.09 €	- 606,764.94 €	-10.39%
<i>Faturimi- te tjera €</i>	21,123.57 €	71,833.73 €	50,710.16 €	240.06%
<i>Faturimi Total €</i>	5,859,008.60 €	5,302,953.82 €	- 556,054.78 €	-9.49%
<i>Inkasimi nga uji €</i>	5,418,445.39 €	5,111,620.87 €	- 306,824.52 €	-5.66%
<i>Inkasimi - te tjera €</i>	22,423.57 €	69,951.08 €	47,527.51 €	211.95%
<i>Inkasimi Total €</i>	5,440,868.96 €	5,181,571.95 €	- 259,297.01 €	-4.77%
<i>Nr. i Konsumatorëve</i>	56,015	56,525	510	0.91%
<i>% e inkasimit</i>	92.82	97.72	4.90	5.28%
<i>Shpenzimet</i>	4,621,805.30 €	4,128,566.28 €	- 493,239.02 €	-10.67%
<i>Pagat</i>	2,633,389.77 €	2,486,884.79 €	- 146,504.98 €	-5.56%
<i>Rryma elektrike</i>	1,045,470.95 €	934,692.08 €	- 110,778.87 €	-10.60%
<i>Shpe. e derivateveve</i>	88,722.80 €	135,282.39 €	46,559.59 €	52.48%
<i>Miremb. Dhe riparimet</i>	329,159.31 €	167,858.18 €	- 161,301.13 €	-49.00%
<i>Miremb, e automjeteve</i>	75,657.68 €	61,916.88 €	- 13,740.80 €	-18.16%
<i>Shpen. E taksave</i>	99,346.12 €	96,396.26 €	- 2,949.86 €	-2.97%
<i>Kemikalet</i>	37,288.32 €	35,902.61 €	- 1,385.71 €	-3.72%
<i>Shpenzimet tjera</i>	312,770.35 €	209,633.09 €	- 103,137.26 €	-32.98%
<i>Uji I pafaturuar në m3</i>	9,440,977	9,046,730	(394,247)	-4.18%
<i>Uji I pafaturuar ne %</i>	51.95	53.69	1.74	3.35%
<i>Mbulimi operativ</i>	1.18	1.26	0.08	6.61%
	819,063.66	1,053,005.67	233,942.01	28.56%

## 5.6 TRANSAKSIONET KRYESORE TE KRYERA GJATË VITIT 2022

### Pagesat nga KRU- HJ- për operatoret

Tabela Nr.42

Nr.	DATA	Nr. i Dokumentit	Emri I Konsumatorit	Shuma
1	12/19/2022	BPBPZNPOS-004599	Pag.fat.40/2022 K-ING sh.p.k.	98,485.89
2	9/2/2022	NLB-P-00026972	NPT Xerxa fat.111/08	81,295.80
3	7/5/2022	PCB-P-00176856	K-ING sh.p.k. fat. 016/2022	53,065.10
4	12/7/2022	BPBPZNPOS-004537	Pag.fat.22-300-000391 INTERADRIA L.L.C	36,935.00
5	11/25/2022	BPBPZNPOS-004412	Pag.fat.011/2022 PRO Constructions SH.P.K.	31,689.08
6	4/8/2022	NLB-P-00025979	Profitech SH.P.K.	30,000.00
7	4/8/2022	PCB-P-00165462	MMPH - Departamenti i ujerave	26,043.01
8	2/23/2022	NLB-P-00025638	KEK - Bunari I	25,206.33
9	4/15/2022	NLB-P-00026009	KEK - Bunari I	25,198.47
10	1/21/2022	NLB-P-00025445	Posta dhe Telekomit i Kosovës sh.a.	25,000.00
<b>TOTAL</b>				<b>432,918.68</b>

### Pagesat nga konsumatoret për KRU - HJ

Tabela Nr.43

Nr.	DATA	Nr. i Dokumentit	Emri I Konsumatorit	Shuma
1	17.05.2022	KONS-0029796	Qendra Medicinale SPITALI	13,234.04
2	05.08.2022	KONS-0029796	Qendra Medicinale SPITALI	12,349.74
3	14.12.2022	KONS-0029796	Qendra Medicinale SPITALI	11,640.36
4	14.12.2022	KONS-0029796	Qendra Medicinale SPITALI	10,957.92
5	05.08.2022	KONS-0029796	Qendra Medicinale SPITALI	10,483.08
6	11.10.2022	KONS-0029796	Qendra Medicinale SPITALI	10,386.54
7	05.09.2022	KONS-0029796	Qendra Medicinale SPITALI	9,733.34
8	12.07.2022	KONS-0029796	Qendra Medicinale SPITALI	9,034.55
9	17.05.2022	KONS-0029796	Qendra Medicinale SPITALI	8,822.14
10	07.04.2022	KONS-0029796	Qendra Medicinale SPITALI	8,629.54
<b>105,271.25</b>				<b>66,483.68</b>

## 6 DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS

### 6.1 AKTIVITETET KRYESORE

Departamenti Administrativ është një nga Departamentet që ka përgjegjësi të drejtpërdrejt tek Kryeshefi Ekzekutiv dhe Bordi i Drejtorëve.

Departamenti i administratës gjatë këtij viti është marr me përgatitjen e raporteve dhe informatave nga veprimtaria e shërbimit juridik, varësisht nga detyrat dhe obligimet e punës të parapara për këtë departament.

Në kuadër të raportit të Departamentit Administrativ sipas strukturës organizative të Kompanisë janë përfshirë edhe raportet e sektorëve të departamentit të administratës si raporti i punës së zyrës ligjore, i resurseve njerëzore, zyrtarit për siguri dhe shëndet në punë, aktivitetet e Shefit të Sigurimit Fizik të Objekteve dhe Administrator i Rojës për janar - dhjetor 2022.

- Gjatë këtij viti janë përgatitur të gjitha procesverbalet dhe vendimet e dala nga Bordet e Drejtorëve nga Mbledhja e Përgjithshme vjetore me Aksioanrin, Komisionet e Auditimi, dhe Kryeshefi Ekzekutiv i KRU" Hidroregjioni Jugor" Sh. A, Prizren. Për Vendimet dhe Rekomandimet e dala në takimet e BD dhe Komisionit të Auditimit janë njoftuar të gjithë zyrtarët dhe udhëheqësit e Kompanisë pas përfundimit të procesverbalit të takimit përkatës.
- Nga Bordi i Përkohshëm Drejtoreve i K.R.U" Hidroregjioni Jugor" Sh. A, në Prizren bazuar në nenin 7, paragrafi 2 i Statutit të K.R.U" Hidroregjioni Jugor" Sh. A, si dhe kërkesat që dalin nga Neni 34.3 i Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike, pas shqyrtimit të bërë njëzëri miratoi "Rregulloren për rregullimin e procedurave të konkursit në KRU" Hidroregjioni Jugor" Sh.A, dhe Rregulloren për menaxhimin e kërkesave dhe dokumentacionit financiar nga Logjistika.
- Mbështetur në Ligjin Nr. 03/L-087, "Mbi Ndërmarrjet Publike", i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr.04/L-111 dhe Ligjin Nr.05/L-009 si dhe bazuar në Ligjin Nr. 06/L - 016, "Për Shoqëritë Tregtare" neni 197 i këtij Ligji, me vendim të Bordit është bërë Ndryshim Statuti i Kompanisë Rajonale të Ujësjetës "Hidroregjioni Jugor" SH.A, në Prizren, Nr. 01-04/01, datë 19.05.2020. Ky ndryshim në procedurë të rregullt është vazhduar edhe në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve në Republikën e Kosovës që reflekton edhe në ndryshim të Certifikatës së regjistrimit të biznesit .
- Pas përgatitjes së Procesverbaleve të Bordit janë njoftuar të gjitha shërbimet (udhëheqësit) lidhur me rekomandimet e Bordit dhe raportet e kërkuara nga mbledhjet në fjalë.

- Është punuar si pjesë e komisionit për harmonizimin e organogramit aktual të Kompanisë me Rregulloren mbi organizimin e brendshëm, koeficientet dhe sistematizimin e vendeve të punës sipas udhëzimit të propozuar nga KNU.
- Nga zyra ligjore është bërë përfaqësimi i Kompanisë në Gjykatën Themelore të Prizrenit, Malishevës, Dragashit dhe Suharekës si dhe është punuar intensivisht në procedimin e lëndëve të përmbauesit privatë për secilën njësi punuese, lëndë këto që kanë të bëjnë me konsumatorët e amvisërisë dhe bizneset që kanë borxh ndaj shërbimeve të ujësjellësit.
- Zyra ligjore është angazhuar edhe në takime zyrtare me Përmbauesit Privat, ku janë diskutuar problemet me të cilat ballafaqohemi gjatë punës.
- Me autorizim të KE janë përgatitur Vendime për mbikëqyrje të punimeve dhe pranim teknik për projektet e investuara me mjetet vetanake të Kompanisë dhe nga buxheti i Komunave të njësive punuese sipas kërkesës së shërbimit teknik.
- Me Vendim janë formuar Komisionet për regjistrim vjetor 2022 që përfshin: Komisioni për regjistrimin e mjeteve themelore, veglave të rënda dhe inventarit të imët; Komisioni për regjistrimin e lëndëve të para dhe materialit në depon kryesore dhe në servisën e bazhdarimit; Komisioni për regjistrimin e arkës, porto-arkën, kërkuesit dhe blerësit dhe Komisionin Qendror të regjistrimit. Të gjithë komisionet e regjistrimit do të kryejnë regjistrimin prej 29.12.2022 gjerë më 10.01.2023 dhe në fund do të kryhet barazimi me gjendjen e kontabilitetit dhe raporti do të dorëzohet komisionit qendror. Komisioni qendror është i obliguar të përpilojë raport mbi kryerjen e të njëjtës dhe t'ia dorëzojë Kryeshefit Ekzekutiv gjerë më 15.01.2023.
- Në departament të administratës janë përgatitur të gjitha vendimet, që kanë dalë dhe janë aprovuar nga menaxhemti i Kompanisë
- Shërbimi juridik ka përgatitur kontratat në mes të kompanisë dhe palëve të treta nga lëmin e veprimtarisë së Kompanisë.
- Gjithashtu në shërbim të administratës janë lëshuar për të punësuarit të gjitha llojet e aktvendimeve, përgjigjet në kërkesë, autorizimeve dhe vërtetimeve nga fusha e marrëdhënieve të punës.
- Janë bërë vazhdime të kontratave të punëtorëve të Kompanisë të cilët kanë qene në afat për gjashtë muaj dhe një vite, si dhe të punëtorëve që kanë pasur kontratën me mundësi të vazhdimit, pas vlerësimit të kryerjes së detyrave të punës të bërë nga ana e udhëheqësve të sektorëve .
- Për AKK është plotësuar raporti i aktiviteteve të ndërmarra në pajtim me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik për vitin 2021 në KRU "Hidroregjioni jugor" Sh. A, Prizren
- Në ARRU është raportuar numri i punëtorëve i ndarë sipas nacionaliteteve, gjinisë, departamenteve, njësive punuese si dhe mosha mesatare e punëtorëve në Kompani.
- Edhe gjatë kësaj periudhe kompania e "Hidroregjonit Jugor" për shkak të situatave të krijuara në Kosovë si dhe rritjen e numrit të prekurve me Covid-19 ka ndërmarr masa shtesë parandaluese duke bërë dezinfektimin e objekteve të kompanisë.

- Është bërë servisimi i aparateve kundër zjarrit nëpër të gjitha njësitë punuese të Kompanisë me dokumentacion të pranimit dhe të dorëzimit për të gjitha aparatet kundër zjarrit.
- Nga Zyrtari për siguri në punë vazhdimisht është bërë kontrollimi i punëtorëve të shërbimit operativ për kujdesin në punë dhe respektimin e Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, gjatë realizimit të punimeve në eliminimin e defekteve në rrjetin e ujësjellësit dhe të kanalizimit .
- Gjatë vitit 2022 janë realizuar vizita/kontrolla të vazhdueshme brenda dhe jashtë orarit edhe nga Shefit të Sigurimit Fizik të Objekteve dhe Administrator i Rojës në kohë të pacaktuar nëpër të gjitha objektet të cilat sigurohen nga kujdestaret – roje gjatë 24/h, në Kompani.
- Është bërë mbikëqyrje dhe mirëmbajtje e duhur në azhurnimin e rregullt të ueb-faqes, siç parashihet me Ligj mbi NP, janë kryer të gjitha arkivimet, publikimet për autoritetin përkatës sipas ligjit.
- Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në punë, me vendim i është kompensuar punëtorëve pagesa e shpenzimeve të mjekimit nga lëndimi në punë gjatë orarit të punës.
- Janë nënshkruar marrëveshjet e reja për shërbime të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura në mes të Komunës së Prizrenit, Suharekës, Malishevës, Dragashit , Mamushës dhe KRU”Hidroregjioni Jugor”Sh. A.
- Në Departament të Administratës kemi pasur auditim nga Auditori i Zyrës Kombëtare të Auditimit, lënda e auditimit ka qenë mbarëvajtja e punës së Departamentit të administratës gjatë vitit 2021.
- Poashtu auditim kemi pasur edhe nga Auditori i Brendshëm lidhur me menaxhimin e procesit të rekrutimit në kompani për periudhën kohore 01-07/2021 dhe 01-04/2022.
- Është bërë regjistrimi në programin Navision, i kontratave të punës së punonjësve, pushimet vjetore, mjekësore, pushimeve pa pagesë, pushimet për lindje të fëmijës, rastet e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes.
- Po ashtu janë regjistruar në program edhe vlerësimet e punës për vitin 2021 të punëtorëve në K.R.U “Hidroregjioni Jugor” Sh. A.
- Janë përgatitur Letër referencat pasi kjo është kërkuar me shkrim nga operatori ekonomik që ka qenë i kontraktuar nga kompania.
- Është dhënë përgjigje në kërkesës së Koordinatorës së QPS-së -komuna e Prizrenit, lidhur me mbledhjen e të dhënave në Sistemin për Menaxhimin e Performancës Komunale për vitin 2021. Të dhënat e kërkuara kanë qenë numri i përgjithshëm i punëtorëve në kompani, numri i të punësuarve femra, personave me përgjegjësi të kufizuar, të punësuarit nga komunitet pakicë .
- Pjesëmarrja në punëtorin e organizuar nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe Environmental Consulting Team në Orion Conference Centre në Prishtinë me teme: Programi i ndërtimit të kapaciteteve mjedisore dhe sociale. Pjesëmarrës ishin menaxhmenti i lartë të ndërmarrjeve publike në sektorin e ujërave dhe mbeturinave për të siguruar angazhimin e tyre dhe angazhimin e stafit të tyre në proces.
- Pjesëmarrja në Konferencën e ujit në Prishtinë të organizuar nga SHUKOS-SHUKALB.

**PERSONELI – JANAR – MARS 2022**

Tabela Nr.44

Muajt	Nr.i te punsuarve sipas muajve	Vende te plotësuara	Te larguar	Të pensionuar	Te tjera
Janar	328		3	1	Ka vdekur një punëtor
Shkurt	325		1	3	
Mars	321		1	1	

**PERSONELI – PRILL – QERSHOR 2022**

Tabela Nr.45

Muajt	Nr.i te punsuarve sipas muajve	Vende te plotësuara	Te larguar	Të pensionuar	Te tjera
Prill	326	5		1	Ka vdekur një punëtor
Maj	324		1		
Qershor	322		1		

**PERSONELI – KORRIK – SHTATOR- 2022**

Tabela Nr.46

Muajt	Nr.i te punsuarve sipas muajve	Vende te plotësuara	Te larguar	Të pensionuar	Te tjera
Korrik	321			1	
Gusht	321				
Shtator	324	3			

**PERSONELI – TETOR – DHJETOR - 2022**

Tabela Nr.47

Muajt	Nr.i te punsuarve sipas muajve	Vende te plotësuara	Te larguar	Të pensionuar	Te tjera
Tetor	324	3	1	1	
Nentor	324				
Dhjetor	324			3	

Shkëputje te kontratës se punës me vet dëshirë, punonjësit:

1. Forti Skoro – me pozite te punes Gjeodet ne njesin punuese Prizren me date 01.01.2022,
2. Arbnor Gashi - me pozite te punes Punëtor në saldim të gypave ne njesin punuese Prizren, me date 06.01.2022,
3. Jon Bytyçi - me pozite te punes Punëtor fizik ITUN ne njesin punuese Prizren, me date 13.01.2022,
4. Skender Osmani – me pozite te punes Punetor fizik ne njesin punuese Suhareke me date 01.02.2022.
5. Burim Sopaj – me pozite te punes Operator për rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit në njësin Malishevë me date 21.03.2022.
6. Alban Kelmendi – me pozite te punes Lexues ne njesin punuese Prizren me date 06.05.2022,
7. Ali Zgog – me pozite te punes Ndhmës gjeodet ne njesin punuese Prizren me date 01.06.2022,
8. Alban Shala me pozite te punes - Ndhmës gjeodet ne njesin punuese Prizren me date 01.10.2022.

#### KUALIFIKIMI I PUNËTORËVE - GJENDJA: DHJETOR 2022

Tabela Nr.48

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A								
KUALIFIKIMI								
Kualifikimi	Doktoratur	Master	Fakultet	Bachelor	Sh. e mesme	Shkolla fillore	Pa kualifikim	Gjithsejë
Nr. i punetorëve	2	15	24	39	212	32	1	325
Kualifikimi në %	0.62	4.62	7.38	12.00	65.23	9.85	0.31	100.00

#### NUMRI I PUNËTORËVE NË 1000 KONSUMATORË DHE SIPAS GJINISË

Tabela Nr.49

GJINIA:	NR	NR. %
FEMRA:	47	14.46
MESHKUJ:	278	85.54
TOTAL	325	100.00

#### NUMRI I PUNËTORËVE SIPAS NACIONALITETEVE - GJENDJA: DHJETOR- 2022

Tabela Nr.50

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A					
Nacionaliteti	Shqiptarë	Boshnjak	Romë, Ashkali dhe Egjiptas	Turq	Gjithsejtë numri i punëtorëve
Numri i Punëtorëve	285	32	3	5	325

Numri i Punëtorëve në %	87.7	9.8	0.9	1.5	<b>100</b>
-------------------------	------	-----	-----	-----	------------

### Raport i numrit te punetoreve Janar - Dhjetor, 2022

Tabela Nr.51

Nr.	Muaji	Hidroregjioni Jugor	Prizren				Suharekë	Dragash	Malishevë
			Prizren	Bordi	ITUN	<b>Total</b>			
1	Janar	<b>331</b>	222	3	18	<b>243</b>	<b>36</b>	<b>16</b>	<b>36</b>
2	Shkurt	<b>328</b>	221	3	18	<b>242</b>	<b>35</b>	<b>16</b>	<b>35</b>
3	Mars	<b>324</b>	218	3	18	<b>239</b>	<b>35</b>	<b>16</b>	<b>34</b>
4	Prill	<b>329</b>	221	3	18	<b>242</b>	<b>37</b>	<b>16</b>	<b>34</b>
5	Maj	<b>324</b>	219	0	18	<b>237</b>	<b>37</b>	<b>16</b>	<b>34</b>
6	Qershor	<b>322</b>	217	0	18	<b>235</b>	<b>37</b>	<b>16</b>	<b>34</b>
7	Korrik	<b>321</b>	217	0	17	<b>234</b>	<b>37</b>	<b>16</b>	<b>34</b>
8	Gusht	<b>327</b>	219	6	16	<b>241</b>	<b>36</b>	<b>16</b>	<b>34</b>
9	Shtator	<b>330</b>	221	6	16	<b>243</b>	<b>36</b>	<b>16</b>	<b>35</b>
10	Tetor	<b>331</b>	222	6	16	<b>244</b>	<b>36</b>	<b>16</b>	<b>35</b>
11	Nentor	<b>331</b>	224	6	16	<b>246</b>	<b>35</b>	<b>16</b>	<b>34</b>
12	Dhjetor	<b>331</b>	224	6	16	<b>246</b>	<b>35</b>	<b>16</b>	<b>34</b>

### Numri i punëtorëve sipas departamenteve dhe moshë mesatare e punonjësve ne HRJ

Tabela Nr.52

DEP. Administratë	DEP. Financave	DEP. Teknik	DEP. Konsumator	DEP Itun	Nj. Suharekë	Nj. Malishevë	Nj. Dragash	Mosha mesatare HRJ
44	13	83	84	16	35	34	16	48

## 6.2 RAPORT I ZYRES LIGJORE - JANAR- DHJETOR 2022

Tabela Nr.53

Muaji	Seanca përgatitore	Seanca kryesore	Seanca të shtyra	Ndërmjetësi m
Janar	1	1	/	/
Shkurt	/	1	1	1
Mars	/	1	3	1
Prill	/	1	/	1
Maj	/	1	1	2
Qershor	1	1	2	1
Korrik	2	/	2	7
Gusht	/	/	2	2
Shtator	/	/	1	1
Tetor	/	3	1	3
Nëntor	/	2	1	/
Dhjetor	1	2	1	1
<b>Totali</b>	<b>5</b>	<b>13</b>	<b>15</b>	<b>20</b>

## RAPORTI VJETOR I PUNËS 2022

Tabela Nr.54

	Totali
Aprovime të pjesërishtme	74
Aktvendime në favor të Kompanisë	19
Aktvendime kundër Kompanisë	3
Me përfaqësues	22
Thirrje për seanca	23
Aktvendime urdhërohen debitorët	/

Korrigjime të Aktvendimeve	/
Aktvendime E.nr.	/
Aktgjykime për Kallëzime Penale në favor të Kompanisë	1
Aktgjykime për Kallëzime Penale kundër Kompanisë	2
Aktvendime për Kallëzime Penale në favor të Kompanisë	/
Aktvendime për Kallëzime Penale kundër Kompanisë	1
Me ndërmjetsim	15
Kallëzime penale	64
Kallëzime penale me marrëveshje	1
Kallëzime penale të përfunduara	/
Ftesë nga Prokuroria	/
Padinga kompania	/
Padi kundër kompanisë	/
Përgjigje në Padi	1
Tërheqje e Padive	/
Ekspertizë në favor të Kompanisë	/
Ekspertizë në dëm të Kompanisë	/
Revizion	/
Përgjigje në Revizion	/
<b>APELI</b>	
Aktgjykim në favor të kompanisë	/
Aktgjykim kundër kompanisë	/
Aktvendime në favor të kompanisë	1
Aktvendime kundër kompanisë	/
Ankesa	7
Përgjigje në Ankesë	1
Konkluzione të ndryshme	1
Konkluzione për njoftime të gjykatave	9
Njoftime dhe Kërkesa	5
Urdhëresë për pagesë të Garancisë	/
Ujdi Gjyqësore	/
Pagesë të Taksës Gjyqësore	5

### 6.3 LËNDËT TË CILAT KËRCËNOJNË KOMPANINË

Tabela Nr.55

Nr.	C.nr.	Kontesti	Vërejtje
1	C. nr. 116/03, datë 08.05.2013	Padi për kompensim dëmi.	Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë
2	C.nr. 286/14, datë 03.06.2015	Padi – Kontest nga marrëdhënia e punës	Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë
3	C.nr. 170/18, datë 14.09.2018	Padi – kompensim dëmi	Gjykata Themelore e Prizrenit me Aktgjykim e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, dhe tani Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit në Prishtinë.
4	C.nr. 471/2017, datë 06.10.2017	Padi – kompensim dëmi	Nga Gjykata e Apelit lënda është kthyer në Gjykatën Themelore të Prizrenit në rigjykim dhe rivendosje
5	C.nr. 416/18, datë 24.05.2018	Padi – Kontest pronësor	Gjykata Themelore e Prizrenit me Aktgjykim e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, dhe tani Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit në Prishtinë.
6	C.nr. 99/16, datë 06.03.2018	Padi – Kontest pronësorë	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren – dega Dragash
7	C.nr. 364/16, datë 12.10.2016	Padi – Kontest pronësorë	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren – dega Suharekë
8	C.nr. 745/05	Padi për kompensim dëmi	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren
	05.09.2005		
	C.nr. 68/17 (Nr. i ri)		
	08.10.2015		
9	C.nr.1902/2019	Padi – Kontest nga marrëdhënia e punës	Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit në Prishtinë.
10	C.nr.251/20	Padi për kompensim dëmi	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren

11	C.nr. 1030/20 27.07.2020	Padi – Kontest nga marrëdhënia e punës	Lënda gjendet në Gjykatën E apelit në Prishtinë
12	CP. Nr. 1024/20 19.01.2021	Propozim për përmbarrim	Në Gjykatën Themelore në Prizren
13	C.nr.363/20	Padi për anulim të Vendimit Nr.930/20	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren-Dega në Suharekë
14	C.nr.1714/19	Padi – kompensim dëmi material dhe jo material	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren
15	C.nr.504/19	Padi për kompensim dëmi	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren-Dega në Suharekë
16	C.nr.239/18	Padi për kompensim dëmi	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren

**6.4 PUNËT E KRYERA ME PËRMBARUESIT PRIVAT**  
**JANAR – DHJETOR 2022**  
**KRU „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A**

**Tabela Nr.56**

Muaji	Propozime për përmbarrime	Prapësime	Përgjigje në prapësime	Marrëveshje	Tërheqje	Përfaqësues të përkohshëm	Të përfunduara	Ankesa në Gj Apelit
Janar	42	9	9	19	0	1	10	0
Shkurt	11	3	3	22	0	1	8	1
Mars	56	10	10	35	0	3	13	0
Prill	13	4	4	32	0	1	11	0
Maj	60	0	0	10	0	1	16	3
Qershor	0	9	9	11	0	1	3	1
Korrik	56	1	1	22	0	2	10	0
Gusht	26	5	5	19	3	0	21	0
Shtator	54	5	3	26	0	0	2	2
Tetor	1	3	3	33	0	0	18	0

Nëntor	62	2	2	15	0	2	20	0
Dhjetor	17	7	7	21	0	3	9	2
<b>Totali</b>	<b>398</b>	<b>58</b>	<b>56</b>	<b>265</b>	<b>3</b>	<b>15</b>	<b>141</b>	<b>9</b>

## PROBLEMET GJATË PROCESIT TË PUNËS

Vazhdojnë të jen problem lëndët e lartcekura të cilat e kërcënojnë Kompaninë, kemi lëndë që kanë të bëjë me kontest nga marrëdhënia e punës, lëndë që kanë të bëjnë kompensim dëmi, kontest pronësor dhe kontest lidhur me borxhin e ujit .

Gjatë procesit të punës Zyra Ligjore ballafaqohet me probleme të natyrave të ndryshme, ndër të cilat mundë ti përmendim:

Ligjin mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, respektivisht Neni 360, Paragrafi 1, Nënparagrafi 1.1, e parasheh afatin njëvjeçarë të parashkrimit për ujë të pijes, me ç`rast kompanisë po i shkakton dëme të konsiderueshme materiale, pasi që gjykata në shumicën e Vendimeve të cilat po i merr po thirret pikërisht në këtë dispozitë, ndërsa kompania për këto borxhe ka qenë e ngarkuar dhe ka paguar TVSH.

Deri te përmbartimi i lëndës përmbartuesi has në probleme të ndryshme duke filluar nga gabimet në evidentimin e konsumatorëve, ku në propozim për përmbartim figuron emër tjetër, ndërsa shfrytëzues i shërbimeve të ujit është person krejt tjetër.

Mungesa e numrave personal gjithashtu ndikon në vonesa për përmbartimin e lëndëve.

Pasaktësia e adresave të vendbanimit të konsumatorëve gjithashtu ndikon në vonesa për përmbartimin e lëndëve.

Faturimi në emra të vdekurve, sjellë humbje kohe dhe probleme tjera përcjellëse, pasi që të njëjtëve duhet të ju caktohen përfaqësues të përkohshëm.

Kyçjet ilegale të konsumatorëve për kompaninë janë të kushtueshme, mirëpo Vendimet e gjykatave në aspektin e disiplinimit të konsumatorëve kanë dhënë rezultate pozitive edhe pse ato ende janë rezultate fillestare.

Rastet sociale të konsumatorëve gjithashtu na paraqesin problem, sepse neve jemi të detyruar që ti tërheqim propozimet për përmbartim kur bëhet fjalë për rastet e rënda sociale, e që shpenzimet për taksat e përmbartimit bien mbi kompaninë.

## Propozim për zgjidhjen e problemeve

Sipas Zyrës Ligjore për tu zgjidhur problemet e lartcekura, nevojitet angazhim i të gjithë punonjësve dhe në veçanti angazhimi i lexuesve pasi që janë në kontakte të rregullta me konsumatorët, ku faktori kryesor përgjegjës për ti ikur parashkrimit të borxheve ndaj kompanisë do të ishte që të njëjtit të i bindin konsumatorët që të paguajnë të paktën një

pagesë nga borxhi i krijuar brenda vitit kalendarik nga konsumatori, ndërsa sa i përket eliminimit të problemit lidhur me konsumatorët e vdekur, ne propozojmë se zgjidhja më e mirë do të ishte shkyçja nga rrjeti i ujësjellësit nëse pasardhësi nuk pranon të kaloj borxhi në emër të tij.

### **PUNËT E REALIZUARA NGA VITI PARAPRAK**

Vlerësoj se Departamenti Administrativ ka bërë një përmbyllje të kënaqshme të vitit 2022, janë realizuar të gjitha obligimet ligjore të parapara në detyrat e punës si përgjegjësi kryesore dhe në statutin e Kompanisë.

Janë respektuar Politikat e Kompanisë për Procedimin për Përmbarrim të Borxheve të Konsumatorëve të cilët nuk i paguajnë faturat e tyre ndaj Kompanisë për shërbimet e ofruara , për Arkëtimin e të gjitha faturave të pakontestueshme për shërbimet e ofruara.

### **SYNIMET E DEPARTAMENTIT ADMINISTRATIV**

Synim i Departamentit Administrativ është përcjellja dhe zbatimi i të gjitha ligjeve dhe ndryshimeve eventuale që kanë të bëjnë me funksionalizimin sa më të mirë të kompanisë.

Mbetet që në vazhdimësi të punohet në Përpilimin e rregulloreve të nevojshme, për rregullimin e politikave dhe procedurave të përgjithshme të KRU" Hidroregjioni Jugor" Sh. A, duke u bazuar në nevojën për suksesin e mbarëvajtjeve të punëve në Kompani si dhe propozimeve të dala nga Menaxhmenti ,Bordi I Drejtorëve dhe Aksionari-Qeveria e Republikës së Kosovës.

Përfaqësim sa më të mirë në Gjykatë dhe Institucionet kudo që do të paraqitet nevoja.

Të vazhdojmë me nxjerrjen e Akteve të reja, korrigjimet, eventuale të Akteve ekzistuese ku vërejmë se ka vend për intervenime, pastaj të bëjmë ndryshime dhe plotësime të Akteve të brendshme të Kompanisë sipas kërkesave Ligjore.

## 7. RAPORT I AUDITORIT

### 7.1 RAPORT NGA AUDITORI I BRENDSTEM

Raporti në vijim paraqet një rekapitullim të punës dhe aktiviteteve të auditorit të brendshëm në KRU Hidroregjioni Jugor, për periudhën kohore një vjeçare janar – dhjetor 2022. Njëherit, përmes këtij raporti prezantohet niveli i realizimit apo përmbushjes së detyrave të përcaktuara me plan vjetor të punës për vitin aktual.

#### PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

- Fillimisht duhet të theksohet se të gjitha aktivitetet e auditimit, të ndërmarra gjatë kësaj periudhe raportuese, janë zhvilluar në pajtim me planin vjetor të punës së auditorit të brendshëm për vitin 2022, si dhe në bazë të kërkesave shtesë nga ana e Komisionit të Auditimit dhe Bordit të Drejtorëve.
- Fushëveprimi i auditimit ka qenë: periudha kohore janar - dhjetor 2022, e në disa auditime është rishikuar edhe periudha e njëjtë e vitit paraprak 2021, si dhe periudha të mëhershme.
- Objektivë kryesore e këtyre auditimeve ka qenë:
  - Rishikimi i funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm, të dizajnuara nga menaxhmenti;
  - Sigurimi i menaxhmentit të kompanisë që proceset janë kryer në pajtim me ligjet, standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe të auditimit, si dhe aktet tjera të brendshme;
  - Sigurimi i menaxhmentit të kompanisë që proceset e realizuara janë të një performance të duhur duke përbushur kriteret në aspektin ekonomik, të efikasitetit dhe të efektivitetit;
  - Nxjerrja e rekomandimeve praktike për përmirësime aty ku është e nevojshme, si dhe
  - Rishikimi i rekomandimeve dhe niveli i përmbushjes apo implementimit të tyre.
- Karakteri i auditimeve të planifikuara dhe të realizuara ka qenë i fokusuar në aspektin e:
  - pajtueshmërisë me ligjet aplikative dhe aktet tjera interne,
  - performancës, dhe atë
  - financiar.

#### HYRJE

Në pajtim me legjislacionin aktual në fuqi, standardet ndërkombëtare për praktikën profesionale të auditimit të brendshëm, si dhe planit vjetor të punës së auditimit të brendshëm, gjatë kësaj periudhe njëvjeçare, janë realizuar një mori aktivitete.

- Fillimisht është përgatitur raporti vjetor i punës së auditorit të brendshëm për vitin 2021, ku

është bërë prezentimi i punës njëvjeçare lidhur me auditimet e realizuara, subjektet e audituara, prezentimin e konstatimeve, të gjeturave, rekomandimeve, komenteve, si dhe nivelin e adresimit të rekomandimeve.

- Është përgatitur plani strategjik i punës së auditorit të brendshëm për periudhën tre vjeçare 2023 - 2025, si dhe plani vjetor i punës së auditorit të brendshëm për vitin 2023.

Planifikimi parasheh dhe nënkupton detyrat e auditorit të brendshëm në perspektivë, dhe drejtimet strategjike të zhvillimit të kontrollit të brendshëm, në rishikimin e rrjedhave financiare dhe jo financiare të aktiviteteve dhe proceseve në subjektet e kompanisë.

- Subjekte të auditimit kanë qenë pothuajse të gjitha Departamentet dhe Njësitë që funksionojnë në kuadër të kompanisë, sikurse:

- Departamenti i financave – shërbimi i financave, etj,
- Departamenti i administratës dhe personelit, shërbimi i personelit, zyra ligjore, etj
- Departamenti teknik – zyra për planifikim dhe zhvillim, shërbimi i transportit, etj;
- Departamenti rajonal me konsumatorë – shërbimi i inkasimit,
- Zyra e prokurimit,
- Njësitë Punuese në Suharekë, në Malishevë dhe në Dragash,
- Zyra për raportim dhe plan biznes, etj.

- Duhet theksuar se gjatë vitit 2022 janë realizuar gjithsej 17 auditime. Prej tyre të planifikuara me plan vjetor 2022, kanë qenë 13 auditime, ndërsa 4 auditime janë kryer me kërkesë të Komisionit të Auditimit dhe Bordit të Drejtorëve.

- Fushëveprimi i auditimeve: Bazuar në planin vjetor të auditimit, si dhe kërkesave të Komisionit të Auditimit fushëveprimi i auditimit ka qenë i fokusuar në:

1. Menaxhimin e procesit të të hyrave të kompanisë;
2. Menaxhimin e procesit të shpenzimeve rrjedhëse të kompanisë;
3. Menaxhimin e procesit të deklarimit dhe pagesës së TAPersonale dhe KPersonale;
4. Menaxhimin e procesit raportimit;
5. Menaxhimin e procesit të rekrutimit;
6. Menaxhimin e procesit të prokurimit;
7. Menaxhimin e procesit të plan biznesit të kompanisë;
8. Menaxhimin e procesit të inkasimit në DRK;
9. Menaxhimin e transportit dhe mirëmbajtjes së automjeteve zyrtare në ITUN;
10. Menaxhimin e procesit të faturimit dhe inkasimit në Nj.Suharekë;
11. Menaxhimin e procesit të faturimit dhe inkasimit në Nj.Malishevë
12. Menaxhimin e procesit të faturimit dhe inkasimit në Nj.Dragash;
13. Menaxhimin e procesit të dhënies së pëlqimeve dhe lejeve për kyçje;
14. Menaxhimin e procesit të faturimit të kons. “Abi - Elif 19” dhe “Galeria Shopping Mall”
15. Menaxhimin e procesit të faljes së borxhit të KEK, si dhe mos respektimit të kontratës;
16. Menaxhimin e procesit për lëndën gjyqësore të largimit nga puna të punonjësit R.H; si dhe
17. Menaxhimin e procesit të rekrutimit të dy punonjësve, në NJP Prizren.

- Gjithashtu gjatë periudhës kohore njëvjeçare 2022, aktivitetet tjera të auditimit kanë qenë në realizimin e kërkesave tjera ligjore dhe administrative, ku do t'i potencojë disa nga to:

- Angazhimi në ofrimin dhe përgatitjen e dokumentacionit, lidhur fazën e përkohshme dhe të ndërmjetme të auditimit të pasqyrave financiare 2021, nga auditorët e ZKA-së,

- Përgatitja dhe raportimi gjashtë mujor dhe vjetor të punëve dhe aktiviteteve të auditimit, në Njësinë Qëndrore Harmonizuese të Auditimit të Brendshëm, në Ministrinë e Financave;
- Përgatitja e Planit Strategjik të punës së auditorit për periudhën 2023-2025, dhe Planit Vjetor të auditimit për vitin 2023,
- Përgatitja e raporteve të auditimit, si dhe shqyrtimit të tyre në baza mujore dhe tremujore në takimet e menaxhmentit, Komisionit të Auditimit – Bordit të Drejtorëve. etj.

#### KONSTATIMET E PËRGJITHSHME

• Pas përfundimit të proceseve audituese, në pajtim me standardet e auditimit të brendshëm si dhe procedurat e punës së auditimit, është bërë:

- përgatitja e draftraporteve;
  - mbajtja e takimeve me menaxhmentin - subjektet e audituara;
  - diskutimi i konstatimeve, të gjeturave dhe rekomandimeve;
  - finalizimi i raporteve, si dhe
  - rishikimi i implementimit apo adresimit të rekomandimeve.
- Duke u bazuar në testimet e kryera dhe të gjeturat e auditimeve, falë angazhimit dhe profesionalizmit të menaxhmentit, është konstatuar se menaxhimi i proceseve, aktiviteteve si dhe procedurat në KRU “Hidroregjionin Jugor” SHA, në përgjithësi janë zhvilluar:
- në pajtim me ligjet, udhëzimet, dispozitat, rregulloret dhe aktet tjera interne,
  - është treguar performancë e mirë e punës së departamenteve dhe shërbimeve, si dhe
  - është konstatuar një funksionim i mirë i kontrollit të brendshëm.

• Duhet theksuar, se përkundër gjendjes së konstatuar, gjatë auditimit të disa fushave dhe proceseve, janë vërejtur dhe konstatuar disa mangësi, ku dhe janë dhënë rekomandime për tu përmirësuar. Gjatë rishikimit të adresimeve të rekomandimeve të dhëna gjatë periudhës audituese vjetore, të paraqitura në vijim të raportit, është konstatuar se nga 20 rekomandimet e dhëna, 5 prej tyre janë realizuar, 3 pjesërisht janë realizuar, 9 janë në proces të realizimit, ndërsa 3 nuk janë realizuar.

Një pjesë e rekomandimeve i takojnë auditimeve të realizuara gjatë TM4/2022, andaj për shkak të afateve kohore, në pajtim me planet e veprimit, pritet të realizohen gjatë TM1/2023.

Bashkëpunimi i mirë kolegial me udhëheqësit dhe stafin në subjektet audituese, si dhe përkrahja e Kryeshefit Ekzekutiv, Komisionit të Auditimit dhe Bordit të Drejtorëve, konsideroj se ka qenë një indikator i rëndësishëm në realizimin apo përmbushjen e planit vjetor të auditimit për vitin 2022, si dhe aktiviteteve tjera të realizuara të auditorit të brendshëm.

Përmes këtij raporti, dëshiroj tu shpreh falenderimet e mia të gjithëve, duke besuar që ky bashkëpunim të vazhdoj edhe më tutje, në favor të arritjes së qëllimeve, objektivave dhe në përgjithësi të ngritjes së performancës së kompanisë.

## 8 AKTIVITETET E PROKURIMIT PER VITIN FISKAL 2022- KRU- HJ

**Tabela Nr.57**

Titulli i kontrates	Nr.Prokurimit	Data e nenskrimit	Data e skadimit	Operatori Ekonomik	Vlerat e kontrates	Vërejtje
Hulumtimi i kënaqshmërisë së konsumatorëve për periudhën janar-dhjetor 2021 në zonen e shërbimit të cilën e mbulon KRU "Hidroregjioni Jugor" sha	HJ-22-001-236	11.02.2022	15.03.2022	"GLOBAL CONSULTING&DEVELOPMENT ASSOCIATES "SH.P.K.	1, 111.00€	
Ritender Kontrollimi teknik i automjeteve te KRU Hidroregjioni Jugor SH.A Prizren	HJ-22-002-236					Kjo procedur anulohet për shkak të mungeses së ofertuesve
Ritender2 Kontrollimi Teknikë i automjeteve zyrtare të KRU Hidroregjioni Jugor sh.a Prizren dhe njësitë operuese te saj (Malishevë, Suharekë, Dragash).	HJ-22-002-236					Anulohet aktiviteti i prokurimit në munges të ofertuesëve.

Ritender2 Kontrollimi Teknikë i automjeteve zyrtare të KRU Hidroregjioni Jugor sh.a Prizren dhe njësitë operuese te saj (Malishevë, Suharekë, Dragash).	HJ-22-003-236					Anulohet i aktiviteti i prokurimit në mungesë të ofertuesëve.
Furnizim, ndërrim dhe mirmbajtje e gomave të KRU Hidroregjioni Jugor sh.a Prizren.	HJ-22-004-121	13.04.2022	13.04.2023	Dyqan i Pavarur Tregatar Autopjese "Buqa"	47,269.67€	
Furnizim me Klor	HJ-22-005-121	07.04.2022	07.10.2022	Seykos SH.P.K.	26 390,00€	
LOT I Furnizim me paisje per regjistrim te hyrjeve daljeve	HJ-22-006-121	29.08.2022	(Brenda 45 dite nga koha e leshimit te urdherblerjes	N.P.SH. "AFA-ING"	9 920,00€	
LOT II Furnizim me printer per shtypjen e ID kartelave	HJ-22-006-121	14.06.2022	(Brenda 10 dite nga koha e leshimit te urdherblerjes)	InderAdria L.L.C	1,810.00€	
LOT III Fotoaparate digjitale+memory card per fotoaparar(8gb)	HJ-22-006-121	14.06.2022	(Brenda 10 dite nga koha e leshimit te urdherblerjes)	InderAdria L.L.C	1,450.00€	
Furnizim me zhavor dhe pjesë Betonike.	HJ-22-007-121	06.05.2022	08.05.2023	EuroVia SHPK	81,712.50€	

Abonimi dhe mirmbajtja e sistemit GPS per monitorimin dhe menaxhimin e automjeteve te KRU Hidroregjioni Jugor sh.a	HJ-22-008-221	05.05.2022	05.05.2025	"TMS MOBILE" SHPK	21,760.00€	
Hapja e puseve eksploatuese për nevojat e KRU Hidroregjionijugor Sh.A Prizren.-Ritender	HJ-22-009-521	28.09.2022	(Brenda 12muajve)	Grup i Operatorëve Ekonomik HIDROKOS SH.P.K.; Salih B. Shala B.I.	81 520,00€	
Furnizim me material per zyrtar	HJ-22-010-121	07.06.2022	06.06.2023	"ARF" SHPK	21,269.00€	
LOT I Furnizim me paisje për detektimin e rrjetit të ujësjesit- matje të ujit dhe matje të thellesise së puseve . LOT II Furnizim me paisje për nevojat e autoparkut-Servisit	HJ-22-011-121					Anuluar :15.06.2022 ne mungese te ofertuesve
Ritender- LOT I Furnizim me paisje për detektimin e rrjetit të ujësjesit- matje të ujit dhe matje të thellesise së puseve . Ritender-LOT II Furnizim me paisje për nevojat e autoparkut-Servisit të KRU Hidroregjioni Jugor sh.a.	HJ-22-011-121	31.08.2022	(Brenda 10 dite nga koha e leshimit te urdherblerjes)	LOT II: " Profitech " SH.P.K.	3 791,00 €	LOTI:Eshte anuluar ne mungese te ofertuesve

LOT I FURNIZIM ME PAJISJE DHE MAKINERI TË PUNËS, LOT II FURNIZIM ME VEGLA PUNE	HJ-22-012-121	15.06.2022	11.06.2023	LOTII:FURNIZIM ME VEGLA PUNE " HPI " SH.P.K.	22,000.00€	LOT I FURNIZIM ME PAJISJE DHE MAKINERI TË PUNËS,-Anuluar
Furnizim me mobilje per zyre	HJ-22-013-136	18.05.2022		"Trendy Home" shpk	2,235.00€	
LOT I Furnizim me dy(2) server për bazën e të dhënave . LOT II Furnizim me tre(3) UPS. LOT III Furnizim me një kasetë metalike për mbrotje të kabinetit të rrjetit dhe serverëve	HJ-22-014-121			LOT I: " TMS MOBILE " SH.P.K LOT II: STORM ICT L.L.C.	LOTI:12980,00 € LOTII:2 895,00€	LOT III: Anuluar ne mungese te ofertuesve
Furnizim me naftë dhe Benzinë për nevojat e Kompanisë	HJ-22-015-111	15.08.2022	16.08.2023	Petrol Company - SH.P.K.	11 475,00€	
Furnizim me lend djegese-Karburant RITENDER	HJ-22-016-111	06.07.2022	10 dite nga koha e leshimit te urdherblerjes	Petrol Company-SHPK	8,572.00€	
Furnizim me një motociklet	HJ-22-017-136	05.08.2022	7 dite nga koha e leshimit te urdherblerjes	PROAKTIV ONE L.L.C.	1 445,00€	

Zevendesimi dhe zgjerimi i rrjetit te ujesjellesit duke perfshire edhe vendosjen e ujematesve jashte prones private, ne rrugen "Xhavit Syla" - Suhereke.	HJ-22-018-521	12.09.2022	6 muaj nga koha e leshimit te urdherblerjes	" K-ING " SH.P.K.	162 645,78 €	
Furnizim me kositese bari	HJ-22-019-121	23.08.2022	10 dite nga koha e leshimit te urdherblerjes	NPT "Haxhijaha" SHPK	1,200.00€	
"FURNIZIMI ME ELEKTROPOMPA DHE PAISJE KOMANDUESE" - LOT I A Elektromotori dhe pompa centrifugale- B- Pompa centrifugale pa elektromotor LOT II C - Elektromotori dhe pompa zhytëse (CILINDRIKE) LOT III D - INVERTERET (RREGULLATORET) FREKUENTOR - E - Paisjet për lëshim të butë në punë – SOFT STARTERËT LOT IV F - Paisjet për komunikim dhe dirigjim nga distanca "Stacion i pompimit – rezervuar" dhe ngjajshëm	HJ-22-020-111	30.11.2022	29.11.2025	LOT II C - Elektromotori dhe pompa zhytëse (CILINDRIKE) NPSH HITERM-EL	LOT II- 150,000.00€	
	HJ-22-020-111			LOT IV F - Paisjet për komunikim dhe dirigjim nga distanca "Stacion i pompimit – rezervuar" dhe ngjajshëm "ENELDAT" SHPK	6,900.00€	
LOT I:Furnizim me printer mobil per shtypjen e faturave	HJ-22-021-121	23.09.2022	30 dite nga koha e leshimit te urdherblerjes	InterAdria L.L.C	34,935.00€	

LOT II:Furnizim me telefona te mencur per shtypjen e faturave	HJ-22-021-121	22.09.2022	30 dite nga koha e leshimit te urdherblerjes	"Infinit" SHPK	8,783.50€	
Furnizim me karburant	HJ-22-022-136					Anuluar
	N/A					
Titulli Shpallje ne media LOT I Televizion lokal Prizren 1 LOT II Televizioni lokal Prizren 2 LOT III Radio lokale ne gjuhen shqipe Prizren LOT IV Radio lokale ne gjuhen Boshnjake Prizren LOT V Radio lokale Suhareke LOT VI Radio lokale Malisheve LOT VII Radio lokale Dragash	HJ-22-024-225	20.09.2022	16.09.2025	LOT I:Radio Televizioni " Besa"	9 000,00 €	
		20.09.2022	16.09.2025	LOT II:TVPz - TV Prizreni	9 000,00 €	
				LOT III:	Eshte anuluar ne mungese te ofertuesve	
		20.09.2022	16.09.2025	LOT IV:P.T.U. " Omega - 3 "	2 880,00 €	
		22.09.2022	16.09.2025	LOT V:Media Center VALA SH.P.K.	2 880,00 €	
		22.09.2022	16.09.2025	LOT VI:N.P.SH.RADIO " MALISHEVA"	2 880,00 €	
		22.09.2022	16.09.2025	LOT VII: RADIO LOKALE DRAGASHI	2,880.00€	
Rehabilitimi I rrjetit te ujesjellesit ne rruget Vjosa, Maria Kraja, Hajdin Rrahmanaj, Sarajeva dhe Shkodra-Prizren	HJ-22-025-521	02.11.2022	Brenda 3muaj nga koha e leshimit te urdherblerjes	Grupi I Operatoreve Ekonomik NNSH CO-ING; P.M.N SHPK Kroi I Bardhe Prishtine	104,500.00€	
Furnizim me Klor Gas dhe Hipoklorit Natriumi-	HJ-22-026-121	25.11.2022	25.11.2023	Afrim Sadriu B.I	84,666.00€	

Ritender. Kyçjet shteoiake dhe rehabilitimi irrjetit te ujesjellesit- Fshati Preqan-SU	HJ-22-027-521	16.02.2022	Brenda 2 muajve	“V-SHEHU” SHPK	52,276.30€	
Furnizim me paisje te fotokopjeve ekzistuese dhe sertesimi I tyre.	HJ-22-028-136	24.10.2022	30 dite nga koha e leshimit te urdherblerjes	“Infinit” SHPK	2.885.60€	
Auditimi i jashtem per vitin 2022,2023,2024	HJ-22-029-221	24.11.2022	24.11.2024	Nsh “Audit&Conto” SHPK	6,867.60€	
Ritender : Shërbime të veçanta : Kontabilist i Çertifikuar	HJ-22-030-236	05.01.2023	31.03.2023	Emin Sylejmani	590.00€	
Mirembajtja dhe avansimi I softverit	HJ-22-031-225	04.11.2022	04.11.2025	ASSECO SEE SHPK	84,065.40€	
Shtirirja e rrjetit te ri te ujesjellesit ne lagjen Landovice	HJ-22-032-521	24.11.2022	Brenda 2 muajve	Grupi I Operatoreve Ekonomik NNSH “CO-ING” “Hidro Project” SHPK	46,005.80€	
Rehabilitimi dhe zgjerimi i rrjetit të ujesjellesit duke përfshir edhe vendosjen e ujëmatësave jashtë pronës private në rrugën “Zek Bajraktari” - Suharekë.	HJ-22-033-521	12.02.2022	Brenda 3 muajve	“Muratori” SHPK	64,450.30€	
Dezinfektimi,Deratizimin dhe Deinsektimin (DDD) i objekteve të KRU Hidroregjioni Jugor dhe Impijantit te Ujrave te	HJ-22-034-221	09.12.2022	09.12.2025	Samire Osmani P.N	0.09€	

Ndotura-ITUN.						
Furnizim me lende djegëse- (dru bungu)	HJ-22-035-136	05.12.2022	Brenda 1 muajve	Ndermarrja Tregtare Sherbyese "TINI"	3,863.50€	
Furnizim me Rrobe Pune per Punetor	70433702-22-12523- 121	27.12.2022	27.12.2023	"PUNTEX" SHPK	55,550.70€	
Sigurimi(TPL) I automjeteve zyrtare	70433702-22-12564- 236	23.12.2023		Kompania e Sigurimeve EUROSIG SH,A	6,067.74€	

## AKTIVITETET E PROKURIMIT ME VLERE MINIMALE PER VITIN FISKAL 2022

**Tabela Nr.58**

Titulli i kontrates	Nr.Prokurimit	Data e nenshkrimtit	Data e skadimit	Operatori Ekonomik	Vlerat e kontrates
Sigurimi i automjeteve dhe eskavatoreve me TPL	HJ-22-001-247	20.01.2022		KOMPANIA E SIGURIMEVE EUROSIG SH.A.	428,09€
Furnizim me rërë për nevojat e Kompanisë	HJ-22-002-147	11.02.2022		G-PROJECT	950,00€
Furnizim me karrige rrotulluese	HJ-22-003-147	07.02.2022		"TRENDY HOME" SH.P.K.	988,80€
Servesimi i rregullt i gjeneratorit ne ITUN	HJ-22-004-247				Anuluar ne mungese te ofertuesve të përgjegjshëm
Ritender-Servesimi i rregullt i gjeneratorit ne ITUN	HJ-22-004-247	28.03.2022		Nexhmije X. Veseli	643,00€

Sigurimi TPL i veturave	HJ-22-005-247	30.03.2022		KOMPANIA E SIGURIMEVE EUROSIG SH.A.	745,95€
Furnizim me tonera për nevojat e kompanisë	HJ-22-006-147				Anuluar ne mungese te ofertuesve të përgjegjshëm
Shërbim për gdhendjen e pjeseve fazonike per eliminimin e defekteve ne teren te operatives	HJ-22-007-247	21.06.2022		Besnik Re.Gashi B.I	965.00€
Furnizim me karburant per nevojat e kompanise	HJ-22-008-147	21.06.2022		Petrol Compani SHPK	812,50€
Furnizim me kositese bari	HJ-22-009-147	24.06.2022		Npt "Moni"	352,00€
Furnizim me ngjyre per ngjyrosjen e ujematesave	HJ-22-010-147	24.06.2022		Npt "Moni"	<b>900.00€</b>
Funizim me klima	HJ-22-011-147	20.07.2022		N.P.T. " MONI "	950,00 €
Furnizim me Nafte&Benzine	HJ-22-012-147	05.08.2022		Petrol Company - SH.P.K.	845,45 €
Furnizim me material per nevojat e KRU Hidroregjioni Jugor sh.a Prizren	HJ-22-013-147	07.10.2022		N.P.T. " MONI "	977,00€
Furnizim me Pjes per Eskavator&Cisterna Kanalizimi	70433702-22-12890-1-4-7	17.11.2022		Bahri Çabrati B.I.	970.00 E
Furnizim me Antifriz -70grad per Makineri te Autoparkut	70433702-22-14186-1-4-7	13.12.2022		Dyqani i Pavarur Tregtar Autopjesë " Buqa "	795.00

## 9. DRAFT PASQYRAT FINANCIARE – 2021-2022

### K. R. U. " HIDROREGJIONI JUGOR " SH.A.

#### DRAFT - Pasqyra e pozitës financiare

më 31 dhjetor 2022

	Shënimi	2022	2021
		€	€
<b>PASURITË</b>			
<b>Pasuritë afatshkurtra</b>			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	4	1,849,285	1,349,695
Investimet financiare afatshkurtra		-	
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	5	1,107,546	1,447,179
Stoqet	6	544,906	601,693
Pasuritë e tjera afatshkurtra	7	9,910	10,161
<b>Gjithsej pasuritë afatshkurtra</b>		<b>3,511,647</b>	<b>3,408,728</b>
<b>Pasuritë afatgjata</b>			
Investimet në pjesëmarrje		-	-
Investimet në filiale		-	-
Investimet financiare afatgjata - objekte ndertimore	8	2,821,634	2,837,807
Prona, pajisjet dhe impiantet	8	1,363,632	1,320,883
Prona investuese -tokat	8	2,956,300	2,956,300
Investimet në vijim	8	12,663,882	12,660,602
Pasuritë e paprekshme	8	74,095	84,967
Pasuritë e shtyra tatimore			
Pasuritë e tjera afatgjata	8	12,546,177	13,038,352
<b>Gjithsej pasuritë afatgjata</b>		<b>32,425,721</b>	<b>32,898,911</b>
<b>Gjithsej pasuritë</b>		<b>35,937,368</b>	<b>36,307,639</b>
<b>DETYRIMET DHE EKUITETI</b>			
<b>DETYRIMET</b>			

**Detyrimet afatshkurtra**

Mbitërheqja bankare		-	-
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	9	1,915,716	2,641,135
Kreditë dhe huatë, pjesa afatshkurtër	10	-	3,997
Interesi i pagueshëm		-	-
Tatimi në fitim i pagueshëm		-	-
Provizionet afatshkurta		-	-
Detyrimet ndaj lizingut, pjesa afatshkurtër		-	-
Detyrimet e tjera afatshkurtra ( detyri. ndaj kons.ne parapagim )	11	108,677	83,729
<b>Gjithsej detyrimet afatshkurtra</b>		<b>2,024,393</b>	<b>2,728,862</b>
<b>Detyrimet afatgjata</b>			
Kreditë dhe huatë, pjesa afatgjatë	12	8,186	8,186
Provizionet afatgjata		-	-
Detyrimet ndaj lizingut, pjesaafatgjatë		-	-
Detyrimet e shtyra tatimore	13	1,516,138	1,522,763
Detyrimet e tjera afatgjata	14	20,121,304	19,791,975
<b>Gjithsej detyrimet afatgjata</b>		<b>21,645,629</b>	<b>21,322,924</b>
<b>Gjithsej detyrimet</b>		<b>23,670,022</b>	<b>24,051,786</b>
<b>EKUITETI</b>			
Kapitali aksionar	17	25,000	25,000
Fitimet - humbjet e mbajtura	17	(7,971,909)	(8,165,083)
Fitimi - humbja e vitit	17	354,151	193,178
Rezervat e tjera	17	14,574,432	14,574,432
Rivlersimi I asetëve	17	5,285,671	5,628,326
<b>Gjithsej ekuiteti</b>		<b>12,267,346</b>	<b>12,255,853</b>
<b>Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet</b>		<b>35,937,368</b>	<b>36,307,639</b>

**K. R. U. " HIDROREGJIONI JUGOR " SH.A.**  
**DRAFT - Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse**  
**për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2022**

	Shënimi	2022 €	2021 €
Të hyrat	15	5,299,964	5,181,404
Kostoja e shitjes		-	-
<b>Fitimi / (humbja) bruto</b>		<b>5,299,964</b>	<b>5,181,404</b>
Të ardhurat tjera	15	<u>578,867</u>	<u>387,155</u>
Shpenzimet e shpërndarjes	15	(3,614,783)	(3,380,847)
Shpenzimet administrative	15	(514,372)	(509,553)
Shpenzimet e amortizimit-zhvlersimit	15	(914,867)	(873,431)
Shpenzimet e tjera	15	(480,657)	(611,551)
<b>Fitimi / (humbja) operativ</b>		<b>354,151</b>	<b>193,178</b>
Shpenzimet financiare		-	-
Të ardhurat financiare		-	-
<b>Fitimi / (humbja) para tatimit</b>		<b>354,151</b>	<b>193,178</b>
Shpenzimet e tatimit në fitim		-	-
<b>Fitimi / (humbja) i/e vitit</b>		<b>354,151</b>	<b>193,178</b>
<b>Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse:</b>		-	-
Diferencat këmbimore nga përkthimi i pasqyrave financiare te operacioneve të huaja, neto nga tatimi		-	-
<b>Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse të vitit</b>		-	-
<b>Gjithsej të ardhurat / (humbjet) gjithëpërfshirëse të vitit</b>	18	<b>354,151</b>	<b>193,178</b>

## 10. PRESPEKTIVA PËR VITIN E ARDHSHËM

### Qellimet dhe objektivat strategjike për vitin 2022

Si qellime kryesore të KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh.A. janë:

- Kontinuiteti i vazhdueshëm i prodhimit të ujit të pijshëm,
- Kontrolla e kualitetit të ujit të pijshëm të jetë në pajtim me instruksionet e lëshuara ngarregullorret në fuqi.
- Rritja e shkallës së inkasimit si dhe zvogëlimi i ujit të pafaturuar
- Rritja e shkallës së efikasitetit të punëtorëve.

### Objektivat kryesore të KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh.A

- Mirëmbajtja e stabilimenteve Elektro-makinerike,
- Mirëmbajtja e rrjetit të ujit të pijshëm dhe ujërave të zeza me qëllim të zvogëlimit të humbjeve në rrjet dhe evitimin e prishjeve me kohë,
- Aktivitetet në përfundimin e projekteve për instalimin e ujëmatëseve,
- Përpjekjet që çdo konsumatori të matet sasia e ujit të shpenzuar dhe të bëhet faturimi në bazë të sasisë së ujit të shpenzuar,
- Pasurimi i Sistemit Gjeografik të Informimit me të dhëna të reja,
- Përpjekjet maksimale në identifikimin e klientëve të rinj,
- Angazhimi në mbledhjen e borxheve të vjetra si dhe inkasimi i faturave rrjedhëse,
- Identifikimi dhe rritja e numrit të konsumatorëve përfshirë këtu edhe lidhjet ilegale,
- Vazhdimi i informimit të konsumatorëve dhe bashkëpunimi me organet komunale në mënyrë që shfrytëzimi i ujit të bëhet në suaza normale,
- Trajnimi i kuadrove në fusha të ndryshme si: në teknologjitë bashkëkohore të trajtimit të ujërave të pijshëm dhe ujërave të zeza, në fushën e ekonomisë, financave, etj.

## 11. INVESTIMET KAPITALE

### 11.1 INVESTIMET E PLANIFIKUARA – 2022

Tabela Nr.59

	INVESTIMET NGA MJETET VETANAKE	VITI
Nr	NJËSIA	2022
1	NJ.P. PRIZREN	559,000.00
2	NJ.P- SUHAREKË	108,000.00
3	NJ.P. - MALISHEVË	78,100.00
4	NJ.P. - DRAGASH	25,000.00
5	NJ.P. - MAMUSHË	5,000.00
	<b>KRU,, HIDROREGJIONI JUGOR" SH..A - PRIZREN</b>	<b>775,100.00 €</b>

Tabela Nr.60

	INVESTIMET NGA GRANDET/ DONACIONET	VITI
Nr	NJËSIA	2022
1	NJ.P. PRIZREN	31,140,000.00
2	NJ.P- SUHAREKË	7,464,981.79
3	NJ.P. - MALISHEVË	6,739,900.00
4	NJ.P. - DRAGASH	255,000.00
5	NJ.P. - MAMUSHË	15,000.00
	<b>KRU,, HIDROREGJIONI JUGOR" SH..A - PRIZREN</b>	<b>45,614,881.79 €</b>

### 11.2. INVESTIMET E REALIZUARA

JANAR- DHJETOR 2022

KRU – „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A

### INVESTIMET VETANAKE

Tabela Nr.61

NR.	EMRI I PROJEKTIT	PËRSHKRIMI I PROJEKTIT	INVESTITORI	SHUMA-€
1	Furnizim me Automjete	Hj-21-024-121	HRJ	36,838.98
2	Furniz.me 2 kamioneta-	Hj-20-024-122	HRJ	61,347.46
3	Furniz.me motcikël	22-shv01-3	HRJ	1,224.58
4	Lidhje shtëpiake Grejkoc Su-	Hj-21-015-521	HRJ	6,383.88
5	Makineri paisje-Pompa dhe mjete tjera	fat.ndryshme	HRJ	

				12,048.08
6	Punime-Mirëmbajtja stac.filtrave Dr.	hj-21-015-521	HRJ	10,668.69
7	Punime komores 40 burime Pz.	hj-21-015-521	HRJ	20,348.15
8	Rrgullimi I kaptazhes Nashec Pz.	hj-21-015-521	HRJ	26,855.15
9	Rregullimi te zyzret e vjetra	hj-21-015-521	HRJ	16,602.90
10	Paisje mirmbajtje	Hj-19-034-221	HRJ	27,765.26
11	Paisje të zyreve	fat.të ndryshme	HRJ	7,250.04
12	Paisje IT	fat.të ndryshme	HRJ	68,745.57
13	Rr.Gj Kastrioti Ma	fat.të ndryshme	HRJ	4,359.29
14	Mirëmbajtje rrjeti në Novak Pz	f.1/22	HRJ	4,171.00
15	Hapja Pusit Novak Pz	hj-22-009-521	HRJ	5,352.54
16	Rehabilitim rrjeti fi 90 Kobaj Pz hj-21-015-521	hj-21-015-521	HRJ	6,775.42
17	Rehabilitim rrjeti rr. Alpet Shqiptare	hj-21-015-521	HRJ	6,662.84
18	Rehabilitim rrjeti rr.R.Kabashi	hj-21-015-521	HRJ	13,873.72
19	Rehabilitim rrjeti rr. Trepqa	hj-21-027-521	HRJ	49,254.95
20	Ndertimi muri mbrojtës 40burime	hj-21-015-521	HRJ	17,247.74
21	Rehabilitim rrjeti rr.I.Rugova Ma	f.111/08	HRJ	68,894.75
22	Rrjet uji Landovic Pz	14/200	HRJ	18,005.49
23	Hapja pusit Doberdelan	hj-22-009-521	HRJ	13,313.56
24	Rehabilitim rrjeti rr.A.Shkreli	f.21+26	HRJ	8,370.74
25	Ndrrimi Gypit Cvileni Pz	104/12	HRJ	10,115.09
26	Rehabilitim rrjeti rr.Vjosa	10+13/22	HRJ	31,188.19
27	Vendosja ujmatesve 3/4 Malishev	99	HRJ	425.25
28	Vendosja ujmatesve 3/4 rr,Xh.Syla	40/22	HRJ	4,649.06
29	Ujmatsa Zonal Ma	584,585	HRJ	4,408.03
30	Ujmatsa Zonal Ma	586,587	HRJ	1,671.44
31	Ujmatsa Zonal Ma	108/12	HRJ	5,847.29
32	Ujmatsa Zonal Pz	105/12	HRJ	3,939.08
33	Ujmatsa Zonal Sr	107/12	HRJ	3,277.36
34	Ujmatsa Zonal Grejkoc Sr	d.201.2.3,4	HRJ	

				7,538.29
35	Ujmatsa Zonal Suharekë	d.648	HRJ	1,821.24
36	Vendosja e ujmatesve Reqan	d.59,78,146	HRJ	8,933.75
37	Rehabilitim Rrjeti kanalizimit Su	02//2022	HRJ	4,247.19
	<b>TOTAL</b>			<b>600,422.04</b>

38	Inv.vijim rrjet uji Peqan	19/2022	HRJ	1,851.69
39	Inv.vijim rrjet uji rr.Z.Bajraktari Su	11./2022	HRJ	5,369.28
	<b>TOTAL</b>			<b>7,220.97</b>
	<b>TOTAL- Te përfunduara dhe ne vijim</b>			<b>607,643.01</b>

## INVESTIMET NGA DONATORËT – DHE KK

Tabela Nr.62

NR.	EMRI I PROJEKTIT	PËRSHKRIMI I PROJEKTIT	INVESTITORI	SHUMA-€
1	Furnizim me Automjete	f.3150+3151	P2M Berlin	43,713.10
2	Makineri paisje-Detektuese- Dragash	fat.ndryshme	KK Dragash	8,930.00
3	Punime-Mirëmbajtja st.filtrave -Dragash	fat.14/22	KK Dragash	10,000.00
4	Rehabilitim rrjeti rr.I.Rugova- Prizren	f.111/08	KK Prizren	12,990.44
5	Rehabilitim rrjeti rr.Xhavit Sylaj- Suharekë	hj-21-027-521	KK Suharekë	93,000.00
6	Topalnicë - Suhareke	21-shv-3312	KK Suharekë	652.88
7	Rrjet uji Grejkoc -Suharek	1/UG - PUNA	KK Suharekë	3,843.31
8	Rr.Remzi Ademi -Prizren	53/22 - BURIMI	KK Prizren	7,501.48
	<b>Total Asete donacion</b>	<b>Donacion</b>		<b>180,631.21</b>
8	Investime vijim donacion	d.36/21	kk Sr	4,656.34
	<b>TOTAL vlere Aseteve dhe Investim vijim</b>	<b>Donacion</b>		<b>185,287.55</b>

1	Total I inv. Te perfunduara dhe te regjistruara			<b>781,053.25</b>
2	Total I inv. Ne vijim			<b>11,877.31</b>
3	<b>TOTAL</b>			<b>792,930.56</b>

**INVESTIMET E KONTRAKTUARA – NË VIJIM ( SHUMA NË €- me TVSH)**

Tabela Nr.63

	EMRI I PROJEKTIT	NJËSIA	SIPAS REALIZIMIT 2022		
			Të kontraktuara	Të përfunduara të regjistruara si asete	Në vijim
1	Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit rrugët: "Vjosa, Marie Kraja, Ajdin Rrahmanaj, Sarajeva dhe Shkodra" - Prizren	PRIZREN	<b>104,499.34</b>	36,802.00	67,697.34
2	Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit në lagjen "Qerretët" - Landovicë.	PRIZREN	<b>46,005.80</b>	21,246.48	24,759.32
3	Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit Ø 300mm në Rr. "Edit Durham" - Prizren	PRIZREN	<b>50,000.00</b>		50,000.00
4	1. Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit në zonën "Nënkalaja"- Pz 2. Shtrirja e gypsjellësit PEHD DN 110 në fshatin Kobajë - Pz	PRIZREN	<b>30,000.00</b>	7,995.00	22,005.00
5	Zevendsimi dhe zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit duke përfshirë edhe vendosjen e ujëmatësave jashtë pronës private për rrugët: "Xhavit Sylja 1 dhe 2", "Hajdin Berisha" dhe Lagjes së Urbanizuar - Suharekë	SUHAREKË	<b>69,645.78</b>	5,485.89	64,159.89
6	Vendosja e ujëmatësve të konsumatorve ekzistues jashtë pronës private.	SUHAREKË	<b>52,276.00</b>	2,185.00	50,091.00
7	Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit brenda zonës së shërbimit	SUHAREKË	<b>64,455.96</b>	6,335.75	58,120.21
8	Hapja e puseve testuese dhe eksploatuese.	Suharekë	<b>75,204.00</b>	15,710.00	59,494.00
9	Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit në Malishevë (Ø 90mm), lagja e re.	MALISHEVË	<b>22,400.00</b>		22,400.00
<b>10</b>	<b>TOTAL</b>		<b>514,486.88</b>	<b>95,760.12</b>	<b>418,726.76</b>

Koment: Pjesë e raportit nga Departamenti Teknik për projektet e kontraktuara

## 12 INVESTIMET E PLANIFIKUARA

### 12.1 PLANI I INVESTIMEVE KAPITALE

Plani i Investimeve është një pjese e rëndësishme e Planit të Biznesit, i cili i mundëson ujësjellësit të përmirësojë shërbimet ndaj konsumatore. Përmirësimi i shërbimeve do të ndikojë edhe në përmirësimin e moralit të pagesave tek konsumatorët.

Plani i investimeve do të përbëhet prej një përzierje të projekteve, ku disa prej tyre do të jenë pjesë e financimit nga Kompania nga të ardhurat e tyre. Megjithatë ekziston një numër i projekteve të mëdha të cilat kërkojnë financim të jashtëm edhe vlerësim të detajuar.

Qëllimi i Planit të Investimeve është që të sigurojë se Kompania është duke bërë planifikim të përshtatshëm për mirëmbajtjen e rregullt dhe zhvillimin e infrastrukture së ujësjellësit. Identifikimi i investimeve, me qëllim të arritjes së ndryshimeve të standardeve të kualitetit apo shërbimeve shqyrtohet sipas vlerësimit të gjendjes së aseteve që janë në dispozicion me qëllim të arritjes së gadishmerisë teknike të pajimeve. Këto investime planifikohen të jenë pjesë e graveve nga KfW, MZHE, MEF, Kuvendi Komunal si dhe nga mjetet vetanake të Kompanisë. Në bazë të analizës dhe gjendjes momentale që kemi në terren, ne kemi përcaktuar prioritetet e investimeve në nivel të Kompanisë-Ndjesive punuese.

Këto prioritetet janë të domosdoshme ngase:

- përmirësohet dukshëm furnizimi me ujë
- përmirësohet cilësia e ujit
- zvogëlohen humbjet teknike dhe komerciale
- shtohet numri i konsumatoreve të rinj
- zvogëlohen shpenzimet operative të mirëmbajtjes
- rritet shtimi i shërbimeve të Kompanisë

(Shiko shtesën; Investimet e planifikuara sipas PB- 2023)

### *INVESTIMET – 2023*

Tabela Nr.64

INVESTIMET NGA MJETET VETANAKE	VITI
NJËSIA	2023
NJ.P. PRIZREN	725,900.00
NJ.P- SUHAREKË	80,000.00
NJ.P. - MALISHEVË	40,000.00
NJ.P. - DRAGASH	19,000.00
NJ.P. - MAMUSHË	2,000.00
<b>KRU,, HIDROREGJIONI JUGOR" SH..A - PRIZREN</b>	<b>866,900.00 €</b>

Tabela Nr.65

INVESTIMET NGA GRANDET/ DONACIONET	VITI
NJËSIA	2023
NJ.P. PRIZREN	22,260,000.00
NJ.P- SUHAREKË	6,550,919.79
NJ.P. - MALISHEVË	5,709,000.00
NJ.P. - DRAGASH	1,690,000.00
NJ.P. - MAMUSHË	17,500.00
<b>KRU,, HIDROREGJIONI JUGOR" SH..A - PRIZREN</b>	<b>36,227,419.79</b>

### 13. RAPORT I DEPARTAMENTIT TE UN-ITUN

Departamenti i UN-ITUN ne fushe veprimtarine e tije perfshinë:

- Grumbullimin e ujerave te ndotura per qytetin e Prizrenit, Malisheves Suharekës dhe Dragashit permes sistemeve egzistuese dhe sistemeve te reja ne ndertim e siper,
- Mirembajtjen e ujerave te ndotura per qytetin e Prizrenit, Malisheves Suharekës dhe Dragashit permes sistemeve egzistuese dhe sistemeve te reja ne ndertim e siper,
- Konsolidimin e sistemeve egzistuese dhe Planifikimin e sistemeve te reja te kanalizimeve ne nivel regjional,
- Trajtimin e ujerave te ndotura permes Impianteve per trajtimin e ujerave te ndotura te cilat jane ndertuar, jane ne ndertim e siper dhe do te ndertohen ne te ardhmen.
- Konsolidimin e impianteve egzistuese dhe planifikimin e impianteve te reja centrale dhe parciale ne nivel regjional,
- Monitorimin dhe konsolidimin e ujerave industriale ne nivel regjional,
- Garantimin e parametrave te efluantit sipas direktivave dhe udhezimeve ne fuçi te cilat percaktojne shkallen e ndotjes e cila lejohet te shkarkohet ne trupat pritese.
- Aktualisht jemi duke operuar me ITUN per qytetin e Prizrenit dhe jemi ne procedure te menaxhimit edhe me Impiantin e Bukoshit-Suhereke dhe Impiantin e Kukit-Dragash.

#### SATATUSI I PROJEKTIT FAZA-1-

**Ndertimi i kolektorit kryesor dhe interceptoreve ne rruge, ana e djathte e rrjedhjes se lumbardhit**

Ky projekt ka perfunduar ne vitin 2017, qe nga viti 2017 eshte ne funksion kolektori dhe 7 intereceptoret te cilet sherbejne per rregullimin hidraulik te kolektorit.

Me kete rast ju njoftojme se kemi patur nje defekt ne pompen shtytese te cilen e kemi derguar ne muajin shtator tek furnizuesi TIMAK per riparim, sipas informatave fillestare pompa do te sanohet ne fund te muajit Tetot.

Raporti perfundimtar i kompletimit te projektit per fazen 1 eshte kompletuar dhe do te dergohet si draft ne departamentin e financave, kurse si raport i kompletuar i cili nenkupton perfundimin e kompletuar te fazes 1 do te dergohet bashk me raportin perfundimtar per fazen 1 dhe 2, pasi qe te miratohet nga KfW-ja, qe nenkupton se kjo faze e projektit munde te regjistrohet perfundimisht si aset i kompanise.

#### **SATATUSI I PROJEKTIT TE ITUN-se FAZA-2-**

Meqenese Periudha e Njoftimit te Defekteve (PNJD-DNP) per linjen e llumit ka perfunduar me 06.10.2022, ju njoftojme se vazhdojme te jemi ne fazen e pranim-dorezimit te projektit te impiantit ne Prizren, pasi qe disa pune te pa perfunduara jane ne proces te perfundimit, prandaj fillimisht po ju raportojme per statusin e projektit te ITUN-se.

Projekti i ITUN-se per qytetin e Prizrenit eshte leshur ne operim ne Dhjetor te vitit 2019 dhe ate gjate fazes se testimave te cilat kan qene pjese e kontrates dhe si te tilla kan qene aktivitetete te realizuara nga kontraktori.

Kjo periudhe e testimave eshte ndare ne dy linja, ne linjen e ujit te ndotur dhe linjen e llumit.

Testet per linjen e ujit kan filluar ne dhjetor 2019 dhe kan perfunduar me 24.06.2021, me crast dhe eshte leshuar certifikata e perkohshme marrjes persiper nga Punedhenesi dhe konsulenca, respektivisht nga Hidroregjioni dhe P2m Berlin&IDOM&Alb Architect.

Pergjate kesaje periudhe deri me 24.06.2021, te gjitha shpenzimet operuse dhe te mirembajtjes kan qene obligim i kontraktorit, pas kesaje date shpenzimet e operimit kan kaluar tek punedhenesi, konkretisht te Hidroregjioni Jugor. Periudha e DNP-se (Periudha e njoftimit te defekteve) per linjen e ujit ka filluar me 24.06.2021 dhe ka perfunduar me 24.06.2022, permes ketije raporti ju njoftoj se DNP (periudha e njoftimit te defekteve) per linjen e ujit te ndotur ka perfunduar me date 24.06.2022, gjithmone duke llogaritur se nuk ka linde ndonje nevojte per zgjatje te kesaje periudhe te DNP-se edhe pse kontraktori AQUALIA deri me tani ka sanuar disa defekte te njoftuara pergjate kesaje periudhe dhe eshte ne procedure te perfundimit te puneve te mbetura te cilat duhet ti realizoj-ti perfundoj maksimum deri me 04.10.2022 atehere kur perfundon periudha e defekteve edhe per linjen e llumit.

Ne forme tabelare me poshte jane paraqitur njoftimet e defekteve pergjate periudhes 24.06.2021 deri 24.06.2022 per linjen e ujit te ndotur te cilat jane sanuar nga kontraktori dhe te cilat eventualisht jane ne pritje per tu sanuar.

Nese i referohemi raportit TM3 ne lidhje me punet e paperfunduara, ju njoftoj se jane riparuar dhe jane testuar perfundimisht tre shtreterve te llumit, dhe furnizimi me material per objektin nr.57, do te furnizohet si i parafabrikuar dhe i gatshem per instalim.

Testet e linjes se llumit kan filluar ne Qershor-2021 dhe kan perfunduar pjeserisht me date 04.10.2021 me crast dhe eshte leshuar certifikata e perkohshme e marrjes persiper me verejtjet dhe komentet perkatese nga Punedhenesi dhe konsulenca, respektivisht nga Hidroregjioni dhe P2m Berlin&IDOM&Alb Architect. Testet kan perfunduar pjeserisht per shkak te mungeses se llumit sepse ne kete periudhe kohore uji i ndotur ne hyrje ka qene nen mesataren e ndotjes bazuar ne parametrat ee dizajnit, kontraktori dhe konsulenca detyrohen qe keto teste ti perfundojne brenda periudhes se DNP-se, behet fjale per testet e garancionit.

Pergjate kesaje periudhe deri me 04.10.2021, te gjitha shpenzimet operuse dhe te mirembajtjes kan qene obligim i kontraktorit, pas kesaje date shpenzimet e operimit kan kaluar tek punedhenesi, konkretisht te Hidroregjioni Jugor. Periudha e DNP-se per linjen e llumit ka filluar me 04.10.2021

dhe do te perfundoj me 04.10.2022, gjithmone duke llogaritur se nuk do te linde ndonje nevojë per zgjatje te kesaje periudhe te DNP-se.

Defektet te cilat jane paraqitur gjate kesaj periudhe nga ana jone dhe e konsulences dhe te cilat jane dhe do te duheshin te kryheshin nga ana e kontraktorit do te pershkruajm si me poshte per te dy linjat.

Per sa i perket testeve te nbetura te garancionit per linjen e llumit, ende jemi duke diskutuar me te dy konsulencat e projektit per percaktimin e metodologjise nga kontraktori se si munde te realizohen perfudimisht testet e garancionit per linjen e llumt.

Pas perdundimit te DNP-se (Periudhes se njoftimit te defekteve) per te dy linjat do te leshohet raporti i kompletimit te projektit, ku do te nenkuptohet si pranim i pergjithshem teknik.

Konsulenca e projektit sipas kontrates eshte e detyruar te pergadise dhe ta dorezoj raportin e kompletimit per fazen 1 dhe 2, dhe te njejtin ta dergoje tek punedhenesi dhe tek KfW-ja per miratim. Konsulenca e projektit ka dorezuar raportin e kompletimit per fazen 1 me date 02.11.2021, me plotesimet dhe komentet perkatese te kerkuara nga KfW, mirpo per shkak te perfundimit te furnizimit te kamionit thithes-shtytes ende nuk eshte kompletuar raporti perfundimtar per fazen 1, i cili ashtu siq eshte cekur me larte do te finalizohet ne fund te vitit 2022.

Me 8 GUSHT 2022, konsulenca e projektit ka dorezuar raportin e kompletimit te projektit per fazen 2 per rishikim tek ne dhe tek KfW-ja, ky raport e mbulon periudhen prej fillimit te projektit per fazen 2 e deri tek marrja persiper e ITUN-se, kurse periudha e njoftimit te defekteve per fazen 2 sipas konsulences do te mbulohet ne raportin perfundimtar.

Listat per punet e mbetura (Bugs List) eshte duke u perditesuar dhe si te perditesuar do te raportohet ne periudhen TM4. Kjo liste do te verifikohet perfundimisht ne raportin perfundimtar te kompletimit te projektit.

Kontraktori me date 29.12.2021, leshon nje deklarate per kompletimin e projektit me te cilen pretendon per pagese shtese duke ju referuar klejmit nr.15 dhe klejmit nr.16, ne si Departament menjehere kemi reaguuar ndaj kesaje deklarate dhe kemi kerkuar sqarim nga konsulenca e projektit e cila menjehere e ka njoftuar KfW-ne dhe kontraktorin ku dhe permes letres zyrtare e ka njoftuar kontraktorin se nuk ka te drejte per nje pretendim te tille.

Ne si departament rezervojme faktin se kontraktori AQUALIA nuk do ta kerkoje kete kompenzim, prandaj edhe permes raportit TM1 dhe TM2, TM3 po ashtu edhe permes ketij raporti TM4, ju njoftojme se kjo çeshtje do te duhej te meret seriozisht nga menaxhmenti i kompanise dhe te diskutohet edhe njehere permes nje takimi te vecant edhe me Konsulencen edhe me KfW-ne.

Aktualisht jemi ne permbyllje te projektit per fazen 2, ashtu siq eshte cekur me lart te gjitha punimet te parapara ne kontrate do te pasqyrohen dhe vertetohen ne raportin perfundimtar te kompletimit te projektit te cilin do ta perpiloj konsulenca e projektit dhe do te miratohet nga KfW-ja.

Pasi qe te leshohet raporti perfundimtar i kompletimit, kontraktori e gezon te drejten qe te kerkoj certifikaten e performances, ne momenti e leshimit te kesaj certifikate do nenkupton se kontrata ne mes te paleve ka perfunduar.

## **SATATUSI I PROJEKTIT MASAT SHOQERUESE-**

Per sa i perket projektit te Masave Shoqeruese faza 2 e cila ka konsistuar ne asistencen teknike pas leshuarjes ne operim te ITUN-se, kjo periudhe ka qene e planifikuar ne kohzgjatje prej 18 muajsh duke filluar ne janar 2020 dhe do te perfundoje na qershore 2022.

Gjate kesaje periudhe kjo konsulence ka zhvilluar keto aktivitetete te parapara ne kontrate:

- Mbikqyrja dhe verifikimi i puneve te perfunduara,
- Mbikqyrje e procesit te trajnimit,
- Monitorimi dhe trajnimi i stafit te laboratorit,
- Analiza e SCADA-es dhe hartimi i raporteve te saje,
- Digjitalizimi i planit te mirmbajtjes permes MMS,
- Mbikqyrja dhe kerkesat per optimizimin e ITUN.

Kontrata me konsulencen e Masave Shoqeruese DORSCH GROUP ka perfunduar me 30.06.2022, mirpo nuk jane shfrytezuar sherbimet opsionale te cilat i ka parapare kontrata.

Me date 16.06.2022 kemi derguar kerkese ne KfW per vazhdimin e kontartes me konsulencen e Masave Shoqeruese si vijon:

Sic diskutuam me date 23 Maj 2022, deshirojme te kerkojme miratimin tuaj per vazhdimin e kontrates Konsulencen e Masave Shoqeruese.

Ne te kundert Kontrata do te perfundoje me 30 Qershor 2022.

Ky vazhdim do ti mbuloje qeshtjet ne vazhdim:

- Optimizimi i operimit te WWTP, efqiencen e energjise dhe masat per kursimin e kostos.
- Pervetesimi i softuerit te nevojshem per perdorimin e te dhenave nga SCADA te cilat mundesojne manovrimin me eficient te vegles se implementuar per te dhenat historike ne SCADA.
- Trajnime te metutjeshme per operim me Laborator.

Vazhdimi do te jete per 6 muaj (deri ne fund te Dhjetorit 2022).

Akoma jane disa mjete te rimbursueshme dhe sherbime opsionale te mbetura ne kontraten e Konsulences (optional services 1 and 3) qe do te shfrytezohen per mbulimin e ketij adendumi.

Per me teper, adendumi ka me formalizu tarifen e nderprerjes ne vlere prej 8850 Euro per te cilen jemi pajtuar ne emailin e dates 04.06.2021.

Ju lutem gjeni te bashkangjitur adendumin e pergaditur nga Dorsch ne te cilen te gjitha pikat jane te perfshira per arsye sqarimi.

KfW-ne e ka pranuar-miratuar kerkesen tone per mundesine e zgajtjes apo shfrytezimit te sherbimeve opsionale qe parasheh kontrata me DORSCH GROUP.

Konsulenca Masat Shoqeruese do te pergadisin raportin tremujor qe mbulon periudhen Korrik-Shtator, te njejtin do ta dergojne tek KfW dhe HRJ ne fund te muajit Tetor.

Jemi ne proces te sherbimeve nga konsulenca e Masave Shoqeruese dhe ne Muajin Tetor do te jene prezent ne Impiant perfaqesuesit e Dorsch group.

Per sa i  
perket

addendumit nr.2 per Konsulencen Masat Shoqeruese nga DORSCH GROUP i cili perfshin periudhen 01.07.2022 deri me 31.12.2022 ende nuk e kemi pranuar raportet Tremujore nga Dorsch, mbi bazen e te cilave do te pershkruhen te gjitha aktivitetet qe i perkasin kesaj periudhe.

**STRUKTURA ORGANIZATIVE**  
**KRU „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A. PRIZREN**

Organogrami i KRU “Hidroregjioni Jugor”, Sh. A

